

POLITIKA E MBROJTJES

Rritja e mirëqenies dhe
të drejtave të njeriut
në basketboll



Co-funded by
the European Union



**Federata e Basketbollit e
Kosovës**

Varianti i politikës: 1 (shtator 2024)

Data e miratimit: XXXX

Data e rishikimit: XXXX

PËRMBAJTJA

QËLLIMET E POLITIKËS	1
DEKLARATA E MBROJTJES	2
PËRKUFIZIMET	2
PROCEDURAT E RAPORTIMIT	4
UDHËHEQËSI I CAKTUAR PËR ÇËSHTJE TË MBROJTJES	5
HETIMET	6
SANKSIONET	7
MBËSHTETJA	7
REKRUTIMI I SIGURT	7
KËRKESAT PËR TRAJNIM	8
VLERËSIMI I RREZIKUT	9
KËRKESAT PËR PARTNERITET	9
MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RISHIKIMI	9
VEGËZAT PËR INFORMATA TË TJERA	10
SHTOJCAT:	11
FJALORTH I TERMAVE	11
FORMULARI I RAPORTIMIT TË INCIDENTIT TË MBROJTJES	13
SKEMA E RRJEDHËS SË PROCEDURAVE TË RAPORTIMIT	16
FORMULARI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT	17
REFERENCAT	18
KODI I SJELLES	19
UDHËZUES PËR PËRDORIM, HETIM, REAGIM	29
POLITIKA E SIGURISË SË INTERNETIT DHE E MEDIAVE SOCIALE	36
PROCEDURAT MË TË SIGURTA TË REKRUTIMIT DHE PËRZGJEDHJES	40

1.


Qëllimet e politikës

Kjo politikë është e zbatueshme për të gjithë anëtarët e Federatës së Basketbollit të Kosovës ('Federata'), duke përfshirë edhe gjithë stafin dhe vullnetarët e Federatës dhe bashkëpunëtorët në shoqata, klube dhe akademitë përkatëse të basketbollit. Politika dhe politikat dhe procedurat e lidhura me të synojnë:

- të sigurojnë një përvojë të sigurt, pozitive dhe argëtuese basketbolli për të gjithë të përfshirët, me theks të veçantë tek fëmijët dhe të rinjtë,
- të përcaktojnë angazhimin e Federatës për ruajtjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në basketboll,
- të vendosin standarde të larta të sjelljes për të gjithë të përfshirët në basketboll,
- të sigurojnë se të gjithë janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në basketboll,

- të përcaktojnë dhunën, abuzimin dhe format e tjera të dëmtimit,
- të përcaktojnë standardet dhe procedurat për regjistrimin dhe raportimin e zbulimeve, incidenteve ose shqetësimeve të dëmtimit brenda dhe jashtë Federatës,
- të identifikojnë procedurat për hetimin e zbulimeve, incidenteve ose shqetësimeve të dëmtimit,
- të identifikojnë sanksionet e disponueshme për shkelje të politikave dhe procedurave të lidhura me mbrojtjen,
- të sigurojnë se rreziqet në të gjitha aktivitetet e lidhura me basketbollin të identifikohen dhe menaxhohen siç duhet,
- të vendosin standarde të larta për rekrutimin e stafit dhe vullnetarëve,
- të vendosin kërkesa për trajnimin e anëtarëve të komunitetit të basketbollit mbi mbrojtjen e tyre dhe përgjegjësitë për të drejtat e fëmijëve.

Kjo politikë duhet të rishikohet së paku çdo 3 vjet (dhe përditësohet sipas nevojës). Dokumenti duhet të lexohet në lidhje me politikat dhe procedurat e tij shoqëruese. Përkufizimet e termave të përdorur mund të gjenden në Shtojcë.




2. Deklarata e Mbrojtjes

Federata e Basketbollit e Kosovës ('ne') është e përkushtuar që të sigurojë një mjedis në të cilin fëmijët dhe të rinjtë mund të marrin pjesë në aktivitetet e saj dhe të kenë një përvojë të sigurt, pozitive dhe argëtuese, pavarësisht nga mosha, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, kombësia, kultura, përkatësia etnike, prejardhja sociale, feja ose besimi, opinioni politik, ose niveli i aftësisë ose paaftësisë. Mirëqenia e fëmijëve dhe të rinjve është parësore. Ne e pranojmë se të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për t'u trajtuar me respekt dhe pa asnjë diskriminim, për t'u mbrojtur nga dhuna, abuzimi dhe dëmtimi dhe për të folur për çështjet që i prekin ata.

Ne kemi zero tolerancë ndaj dhunës, abuzimit, ngacmimit apo diskriminimit të çdo lloji. Ne jemi të përkushtuar t'u lejojmë të gjithë fëmijëve të aftë të formojnë pikëpamjet e tyre dhe të drejtën për t'i shprehur ato lirisht në të gjitha çështjet që i prekin ata, duke iu kushtuar rëndësi të duhur pikëpamjeve të fëmijëve në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre. Gjatë rishikimit të vazhdueshëm të kësaj politike, ne pranojmë të këshillohemi me fëmijët dhe të rinjtë, prindërit/kujdestarët e tyre dhe bashkëpunëtorët, qofshin me pagesë apo vullnetarë.

Çdokush ka për detyrë të kujdeset për fëmijët dhe të rinjtë dhe kanë përgjegjësi t'i mbrojnë ata nga dëmtimet dhe të respektojnë dhe promovojnë të drejtat e tyre. Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka përgjegjësinë për të siguruar që kjo politikë dhe procedurat shoqëruese të mbrojtjes të ndiqen nga bashkëpunëtorët e tij. Ne presim që të gjitha palët e përfshira në basketboll (qofshin me pagesë ose vullnetarë, në të gjitha nivelet e sportit) të familjarizohen dhe t'i përmbahen kësaj politike dhe politikave dhe procedurave shoqëruese. Çdo shkelje e dyshuar e kësaj politike dhe/ose e politikave dhe procedurave shoqëruese duhet të raportohet menjëherë përmes kanaleve të dhura siç identifikohen në seksionin 5.



3. Përkufizimet

Ne përdorim përkufizimet e mëposhtme për qëllime të kësaj politike dhe politikave dhe procedurave shoqëruese, të cilat përputhen me ligjin e Kosovës (përfshirë [Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve](#) (Nr. 06/L-084)), Politikën Mbrojtëse të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA, 2022), dhe termat e përdorur nga organizatat globale të sportit dhe të drejtave të njeriut. Këto përkufizime duhet të përdoren së bashku me ato të ofruara (siguruara) në fjalorthin në fund të këtij dokumenti.

Abuzimi

“Trajtimi i dikujt me dhunë, mungesë respekti, mizori, dëmtim ose forcë, duke filluar nga mosrespektimi deri te shkaktimi dikujt dhimbje fizike ose mendore” (FIBA, 2022, f.2). Abuzimi mund të klasifikohet në 4 lloje (shpesh gërshetohen): 1) Dhuna/abuzimi fizik, 2) dhuna/abuzimi psikologjik ose emocional, 3) dhuna/abuzimi seksual, 4) shpërfillja.

Bullizmi

Sjellje e përsëritur ose e ashpër që synon të frikësojë ose mërzitë dikë dhe/ose t'i bëjë ata të mos ndihen komod ose të pasigurt, për shembull, përdorimi i emrave nënçmues, përjashtimi ose izolimi, përhapja e thashethemeve, turpërimi i dikujt në publik ose para bashkëmoshatarëve, kërcënim i për të shkaktuar dëm, lëndimi fizik i një personi tjetër ose dëmtimi i pasurisë së tyre ose kombinim i këtyre veprimeve” (FIBA, 2002). Mund të ndodhë personalisht ose në internet.

Diskriminimi

“... trajtim i paarsyeshëm, i pabarabartë lidhur me një ose më shumë arsye të ndaluara” (për shembull, ‘raca’, ngjyra, seksi, feja, orientimi seksual, identiteti gjinor) (Këshilli i Evropës, 2018, f. 7).

Ngacmimi

“... kur një sjellje e padëshiruar në lidhje me seksin e një personi ndodh me qëllim ose për të cenuar dinjitetin e një personi dhe për të krijuar një mjedis

frikësues, armiqësor, denigrues, poshtërues ose fyes” (Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, 2002). Mund të jetë i natyrës fizike, emocionale ose seksuale (FIBA, 2022). Mund të ndodhë personalisht ose në internet.

Detyrimi

“... çdo ritual, aktivitet inicues, veprim ose situatë, me ose pa pëlqim, që rrezikon në mënyrë të pamatur, me dashje ose pa dashje mirëqenien fizike ose emocionale të grupeve të cënueshme” (FIBA, 2022, p. 10).

Dhuna fizike ose abuzimi

“Çdo veprim i qëllimshëm që shkakton lëndim ose traumë te një person tjetër. Kjo përfshin goditjen, goditjen me shuplakë, shtyrjen, shkelmimin, djegien, t’i japësh dikujt ndonjë ilaç që nuk i nevojitet dhe/ose që mund ta dëmtojë ose zbatimin e masave të papërshtatshme të kufizimit” (FIBA, 2022, f. 8). Mund të përfshijë grushtim, rrahje, kapje për fyti, shkelm, kafshim, djegie ose dëmtim [fizik] të një sportisti. Përveç dhunës trupore, në sport mund të përfshijë aktivitet fizik të papërshtatshëm të detyruar ose të detyrueshëm (p.sh., ngarkesa stërvitore të papërshtatshme për moshën ose fizikun, stërvitje të detyruar kur dikush është i lënduar ose ka dhimbje), konsumim i detyruar i alkoolit, teknika të detyruara të menaxhimit të peshës, të dëmshme ose jo të shëndetshme, ose praktikat sistematike të dopingut.

Dhuna ose abuzimi psikologjik/emocional

“... aktet që shkaktojnë ose kanë gjasa të dëmtojnë shëndetin ose zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës” (Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve (Nr. 06/L-084)). Kjo përfshin çdo “vepër ose trajtim tjetër që mund të shkaktojë dëme emocionale dhe të dëmtojë ndjenjën e mirëqenies së një personi, duke përfshirë kritikën e vazhdueshme, denigrimin ose vendosjen e pritshmërive joreale ndaj grupeve të cënueshme, izolimin, sulmin verbal, poshtërimin, fajësimin, kontrollin, frikësimin ose përdorimin e kërcënimeve” (FIBA, 2022, f. 8). Këto akte mund të

jenë nën kontrollin e prindit ose të një personi që ka përgjegjësinë, i është besuar ose ka pushtet dhe përfshin kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, frikësimin, diskriminimin, nënqeshjen ose forma të tjera jo fizike të armiqësisë ose trajtimit refuzues (Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (Nr. 06/L-084)). Mund të përfshijë të bërtitura, thirrje, nënçmime, kërcënime, sharje, përdorimi i emrave nënçmues dhe komente poshtëruese, injorim ose përjashtim të sportistëve, teknika të detyruara të menaxhimit të peshës, të dëmshme ose jo të shëndetshme, ose akte frikësimi si abuzimi verbal, hedhja e sendeve në prani të sportistëve dhe/ose grushtimi dhe/ose thyerja e sendeve para një sportisti.

Dhuna ose abuzimi seksual

“Çdo akt seksual, përpjekje për të marrë një akt seksual, komente apo avantazhe të padëshiruara seksuale, apo akte trafikimi, apo të drejtuara ndryshe kundër seksualitetit të një personi duke përdorur detyrimin, nga çdo person pavarësisht nga marrëdhënia e tij me viktimën” ku pëlqimi detyrohet/manipulohet, ose nuk jepet ose nuk mund të jepet (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2014, f. 84). **Kodi Penal i Kosovës (Nr. 06/L-074)**, përfshin aktet si përdhunimi, sulmi seksual dhe aktivitete të tjera seksuale pa pëlqim. Mund të përfshijë kontakt (p.sh. prekje të padëshiruara) ose asnjë kontakt (p.sh. dhunë seksuale të kërcënuar, ngacim seksual verbal, bërja ose shpërndarja e fotove pornografie).

“Abuzimi seksual është çdo veprim që rezulton në shfrytëzimin e grupeve të cënueshme, qoftë me pëlqimin e tyre apo jo, për qëllime të kënaqësisë seksuale ose erotike. Kjo mund të bëhet nga një i rritur ose një i ri që është intelektualisht, emocionalisht, fizikisht ose seksualisht më i pjekur se viktimë. Abuzuesi mund të jetë gjithashtu çdo person që ka autoritet, ndikim ose epërsi morale mbi viktimën. Kjo përfshin aktivitete pa kontakt, të tilla si ekspozimi i pahijshëm, përfshirja e grupeve të cënueshme në dëshmimin e akteve seksuale, shikimi i imazheve/pornografisë seksuale ose përgatitjen e tyre për abuzim (përfshirë përmes internetit). Edhe nëse fëmijët kanë mbushur ligjërisht moshën e pëlqimit seksual në vendin e tyre, është e papranueshme që dikush të abuzojë me marrëdhënien e tyre të besimit për kënaqësi seksuale” (FIBA, 2022, f. 8).


Neglizhenca

Dështimi i vazhdueshëm për të përmbushur nevojat bazë të një anëtarit të një grupi të cënueshëm, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë (FIBA, 2022, f. 8). Çdo veprim ose mosveprim, i qëllimshëm ose jo, nga një person që është përgjegjës për rritjen, kujdesin ose edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit mund të rrezikohet jeta, mirëqenia fizike dhe mendore dhe zhvillimi i fëmijës. **(Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (Nr. 06/L-084))**. Mund të përfshijë “mos-përmbushjen e nevojave themelore të grupeve të cënueshme, dështimin për të siguruar ushqim adekuat, strehim duke përfshirë përjashtimin nga shtëpia ose braktisjen, dështimin për t’i mbrojtur ata nga dëmtimi ose rreziku fizik dhe emocional, ose mospajtim i qasjes në kujdesin e duhur mjekësor ose trajtim. Mund të përfshijë gjithashtu neglizhencë, ose mos-reagim ndaj nevojave themelore emocionale ... neglizhencë ose praktikë të dobët profesionale ... injorim të nevojave të kujdesit mjekësor, emocional dhe fizik, dështim në sigurimin e ushqimit adekuat, strehim, duke përfshirë përjashtimin nga shtëpia ose braktisjen, dështimin për t’i mbrojtur ata nga dëmtimi ose rreziku fizik ose emocional, ose mospajtim i qasjes në shërbimet e duhura mjekësore, kujdesi dhe mbështetjeje ose arsimore ose ndalimi i nevojave të jetës, të tilla si mjekimi, ushqimi adekuat dhe ngrohja” (FIBA, 2022, f. 9). Në basketboll, neglizhenca mund të përfshijë ekspozimin e sportistëve ndaj të ftohtit ose nxehtësisë së panevojshme pa siguruar veshje ose hidratim të mjaftueshëm, inkurajimin e sportistëve të lozin me lëndime, mosrespektimin e rregullave të sigurisë në sport ose mospajtimin e pajisjeve të përshtatshme, largimin e fëmijës nga/ose kufizimin e arsimit të një sportisti në favor të stërvitjes dhe refuzimi i qasjes në kujdesin e duhur mjekësor për lëndimet.

Praktika e dobët

“Sjellje që nuk ka abuzim, por megjithatë është e papranueshme. Është thelbësore që praktika e dobët të sfidohet dhe të raportohet edhe kur besohet se motivet e një individi kanë qëllime të mira. Dështimi për të sfiduar praktikën e dobët mund të çojë në një mjedis ku dhuna dhe abuzimi ka më shumë gjasa të mbeten pa u vënë re. Incidentet e praktikës së dobët ndodhin kur nevojave të një fëmije ose të riu nuk u jepet përparësia e nevojshme, duke rrezikuar mirëqenien

e tyre” (FIBA, 2022, f. 10). Për shembull, lejimi i praktikave abuzive, shqetësuese ose të dëmshme që të mos raportohen, kontakti fizik me fëmijët pa marrë pëlqimin e tyre (përveç rasteve emergjente), injorimi i udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë ose vlerësimet e rrezikut etj.



4.

Procedurat e raportimit

Mirëqenia e fëmijëve dhe të rinjve është parësore. Ruajtja e fëmijëve dhe të rinjve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre është përgjegjësi e **të gjithëve**. Shqetësimet për mbrojtjen mund të adresohen drejtpërdrejt nga një fëmijë/person i ri që i tregon bashkëpunëtorit (i njohur si ‘një zbulim’); mund të vijnë nga një bashkëpunëtor dëshmitar; cilësohet si vërejtje ose dëgjim i diçkaje, ose informacion që mund të ndahet me bashkëpunëtorin nga një person tjetër (si p.sh. prind) ose një agjenci e jashtme. Ne e kuptojmë se fëmijët dhe të rinjtë me dobësi shtesë (p.sh., një paaftësi) mund të përballen me pengesa shtesë për raportimin e incidenteve ose shqetësimeve dhe ne synojmë të sigurojmë që politikat dhe procedurat tona mbështesin të gjithë fëmijët.

Të gjitha raportimet, incidentet ose shqetësimet e dëmtimit, madje edhe shqetësimet e dyshuara dhe praktikat e dobëta duhet të merren seriozisht dhe duhet të regjistrohen dhe raportohen tek autoritetet përkatëse nëse ato ndodhin brenda ose edhe jashtë kontekstit të basketbollit. Nevojat e fëmijës apo të riut duhet të kenë prioritet. Raportimi mund të bëhet edhe në mënyrë anonime. Raportet anonime do të hetohen njëjtë si çdo raport tjetër.

Nëse një fëmijë ose të riut i kanoset ndonjë rrezik i menjëhershëm ose rrezikojnë dëmtimit të menjëhershëm, kontaktoni menjëherë policinë dhe/ose shërbimet sociale dhe ndiqni procedurën e mëposhtme.

dyshuara) të dëmtimit ose praktikave të dobëta duhet t’i raportohen sa më shpejtë që është e mundur udhëheqësit të Federatës të caktuar për çështje të mbrojtjes (zakonisht brenda 24 orëve). Nëse raporti juaj fillestar është bërë me gojë, ju duhet ta përcillni edhe një raport me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur (zakonisht brenda 24 orëve).

Nëse ka prova të një krimi të mundshëm ose nëse çështja nuk ka lidhje me basketbollin (p.sh. dhuna në shtëpi), udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes duhet t’ia referojë çështjen me shkrim autoriteteve publike përkatëse (p.sh., policia, shërbimet sociale).

Nëse zbulimi, incidenti ose shqetësimi (i dyshuar) i dëmtimit ose praktika e dobët lidhet me basketbollin, por bie nën pragun penal, ose nëse zbulimi, incidenti ose shqetësimi (i dyshuar) i dëmtimit i kthehet Federatës nga autoritetet publike pas një referimi fillestar, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes duhet të hetojë rastin duke ndjekur procedurat e përshkruara në seksionin 6. Grafiku i rrjedhës në shtojcën e këtij dokumenti do t’ju ndihmojë të kuptoni procesin e raportimit.

Si bashkëpunëtor, nëse viheni në dijeni për një zbulim, incident ose shqetësim (të dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët, nuk është përgjegjësia juaj të vendosni nëse një fëmijë është abuzuar ose dëmtuar ose nëse ka ndodhur një praktikë e dobët. Ju nuk duhet të ndërmerrni asnjë hetim. Roli juaj është i kufizuar që të raportoni shqetësimet përkatëse.

Të gjitha raportet e dëmit do të marrin një përgjigje nga udhëheqësi i Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes.

Mbajtja e shënimeve

Të gjitha zbulimet, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) për dëmtim ose praktikë të dobët duhet të regjistrohen në Formularin e Raportimit të Incidentit të Federatës (shih Shtojcën). Nëse nuk jeni në gjendje ta përdorni këtë formular në kohën e zbulimit/ incidentit/ shqetësimit (të dyshuar), duhet ta plotësoni atë pastaj sapo t’ju jepet mundësia e parë. Mbani shënimet tuaja origjinale në rast se ato kërkohen më vonë nga udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes, agjencitë e jashtme ose ndonjë gjykatë. Një kopje e Formularit të Raportimit të Incidentit duhet t’i dërgohet udhëheqësit të caktuar për çështje të mbrojtjes (e identifikuar në seksionin 5) brenda 24 orëve nga njoftimi i herës së parë për zbulimin/incidentin/shqetësimin.



Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Federata do të ruajë të gjitha të dhënat e mbledhura (me shkrim ose në mënyrë elektronike) në lidhje me mbrojtjen e zbulimeve, incidenteve ose shqetësimeve (të dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët. Të gjitha të dhënat do të trajtohen me konfidencialitetin maksimal, me përjashtim të nevojës për të informuar publikun e nevojshëm ose organe të tjera sportive. Të gjitha të dhënat do të menaxhohen sipas Rregulloreve të Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave.

Të gjitha zbulimet, incidentet ose shqetësimet (e

5.

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes

Udhëheqësi i caktuar nga Federata për çështje të mbrojtjes është zyrtarja për integritet (SPOC):

Vlora Braha

Të dhënat kontaktuese:

+38345577058

spocperson@basketbolli.com

Federata gjithashtu ka zyrtarët e mëposhtëm të caktuar për çështje të mbrojtjes, të cilët i raportojnë udhëheqësit të Federatës të caktuar për çështje të mbrojtjes:

XX EMRI XX

Të dhënat kontaktuese: XXXXXX

XX EMRI XX

Të dhënat kontaktuese: XXXXXXXX

Roli i udhëheqësit të Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes është:

- të veprojë si pika qendrore e kontaktit për këdo që kërkon të raportojë një zbulim, incident ose shqetësim (të dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët,
- të njoftojë autoritetet përkatëse publike për çdo zbulim, incident ose shqetësim (të dyshuar) të dëmtimit që mund të përbëjë vepër penale,
- të përcaktojë se çfarë veprimi duhet të ndërmerret për të reaguar ndaj një zbulimi të raportuar, incidenti ose shqetësimi (të dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët,
- t'i referojë (kur është e nevojshme) zbulimet e raportuara, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikave të dobëta te komiteti përkatës i Federatës për hetim dhe/ose veprim disiplinor,
- të përcaktojë nëse dhe çfarë ndjekjeje për të gjitha zbulimet, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët është e garantuar dhe në cilën fazë,
- të monitorojë dhe rishikojë në mënyrë të pavarur të gjitha zbulimet, incidentet ose

- shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët,
- të mbajë regjistër dhe të ruajë në mënyrë të sigurt të gjitha zbulimet, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët,
 - të ofrojë mbështetje për çdo person të interesuar ose të prekur dhe/ose të referojë personat e interesuar ose të prekur te ofruesi i duhur i shërbimit,
 - të kontribuojë në zhvillimin e trajnimeve për të gjithë bashkëpunëtorët për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre,
 - të përpiqet të formulojë dhe zbatojë Programin për mbrojtjen e dëshmitarëve për të mbrojtur sigurinë dhe identitetin e çdo sinjalizuesi(ve), si dhe për të inkurajuar sinjalizuesit e tjerë që të raportojnë rastet e mundshme të dëmtimit, pavarësisht nëse sinjalizuesi është apo jo i lidhur me personin e prekur në çfarëdo mënyre ose është autor i veprës me kusht që të konsiderohet se është më pak fajtor se autorët e tjerë të dëmit.

6.

Hetimet

Udhëheqësi i Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve të zbulimeve, incidenteve ose shqetësimeve (të dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët për çështjet e mbrojtjes bazuar në referimin(et) e marra. Megjithatë, nëse në çdo kohë ata kanë menaxhuar drejtpërdrejt ndonjë nga bashkëpunëtorët e përfshirë në referim, individit alternativ me vjetërsi dhe pavarësi të përshtatshme duhet të caktohet për të udhëhequr hetimin. Oficeri hetues duhet të ketë nivelin e përvojës dhe njohurive profesionale që të jetë në gjendje të analizojë në mënyrë kritike situatën. Ata duhet të jenë në gjendje të mbledhin, grumbullojnë dhe analizojnë informacione nga disa burime.

Të gjitha hetimet do të jenë të plota, të ndjeshme dhe do të ndjekin parimet e praktikës së informuar për traumat për të zvogëluar rrezikun e shkaktimit të dëmit. Të gjitha hetimet do të fillojnë me besimin e fëmijës.

Pas marrjes së një referimi, ai do të ekzaminohet për të konfirmuar se ka të bëjë me një zbulim mbrojtës, incident ose shqetësim (të dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët dhe/ose shkelje të kësaj Politike të Mbrojtjes ose politikave dhe procedurave shoqëruese përkatëse. Nëse e bën këtë, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes (ose një zëvendësimit i caktuar me vjetërsi dhe pavarësi të përshtatshme) duhet të hetojë dhe të vendosë për veprimet e menjëhershme duke i dhënë mbi të gjitha përparësi mirëqenies së fëmijës. Udhëzuesit e Federatës për Hetimin e Incidenteve dhe Shqetësimeve të Mbrojtjes do t'ju ndihmojnë në kryerjen e hetimi.

Mosrespektimi i ndonjë kërkesë të lëshuar nga udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi mund të rezultojë në marrjen e masave kundër atij personi sipas rregulloreve të brendshme të Federatës.

Nëse pala e përfshirë (autori i dyshuar) është një bashkëpunëtor, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes do t'i informojë ata për shqetësimin dhe hetimin në një kohë që ata e konsiderojnë të përshtatshme. Kjo mund të mos jetë e menjëhershme, por do të përcaktohet në bazë të rrezikut të dëmtimit të individëve, rrezikut të paragjykitimit të hetimit, nëse duhet të vendoset ndonjë masë e përkohshme dhe pikëpamjeve të udhëheqësit të caktuar për çështje të mbrojtjes.

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes do të qëndrojë në kontakt të rregullt me të gjithë të përfshirët në një hetim, por ata mund të mos jenë në gjendje të zbulojnë të gjithë informacionin në dispozicion.

Varësisht nga natyra e referimit, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes mund të koordinohet me policinë dhe/ose shërbimet sociale për të mbledhur informacionin, për të hetuar dhe vlerësuar raportin(et); ata edhe mund të kryejnë hetime ndarazi.

Hetimet e udhëheqësit të caktuar për çështje të mbrojtjes mund të përfshijnë:

- kontakt të drejtpërdrejtë me personin(at) që dyshohet se janë prekur,
- kontakt të drejtpërdrejtë me autorin(ët) e dyshuar të veprës,
- kontakt të drejtpërdrejtë me çdo dëshmitar,
- shqyrtim të dokumenteve, imazheve dhe/ose raporteve (përfshirë edhe ato online),
- kontakt me agjencitë ligjore ose organet sportive.

Në përputhje me rregulloret e brendshme të Federatës, procesi për menaxhimin e hetimeve do të jetë i drejtë dhe i hapur dhe do të sfidohet nga procesi ankues. Hetimet do të ndjekin procedurat e përcaktuara në dokumentin Udhëzime për Hetimin e Incidenteve dhe Shqetësimeve të Mbrojtjes.

Në përputhje me rregulloret e brendshme të Federatës, individët që janë duke u hetuar për çfarëdo çështje që lidhet me mbrojtjen, shqetësimet për dëmtim ose praktikën e dobët duhet të pezullohen përkohësisht deri në përfundimin e hetimit.

Rezultatet

Udhëheqësi i caktuar për çështje të sigurisë do të bëjë një raport duke përshkruar gjetjet e tyre. Ndër përfundimet e mundshme janë se:

Vepra penale mund të jetë kryer. Në këtë rast, duhet të përgatitet një raport i shkruar për autoritetet publike përkatëse dhe do të fillohen procedurat disiplinore të brendshme kundër autorit të dyshuar,

Fëmija/fëmijët ka/kanë pësuar ose ka/kanë të ngjarë të pësojë ose është duke pësuar dhunë, abuzim ose dëmtime të tjera. Në këtë rast, duhet të përgatitet një raport i shkruar për autoritetet publike përkatëse dhe do të fillohen procedurat disiplinore të brendshme kundër autorit të dyshuar,

Probleme/shqetësime që lidhen me praktikë të dobët. Do të fillohen procedurat disiplinore të brendshme,

Raporti është, sipas balancës së probabilitetit, pa bazë. Rasti mbyllet dhe nuk do të ndërmerren veprime të mëtejshme.

7. Sanksionet

Paneli Disiplinor i Federatës ka të drejtë të vendosë sanksione për shkeljen e kësaj politike dhe/ose politikave dhe/ose procedurave shoqëruese që lidhen me to. Sanksionet duhet të jenë të drejta, të balancuara dhe proporcionale.

Procedurat disiplinore të brendshme të Federatës përshkruajnë sanksionet në dispozicion. Këto dallojnë nga një qortim dhe/ose një urdhër për të kryer trajnim të detyrueshëm të specifikuar deri te pezullimi (i përkohshëm ose i përhershëm) dhe/ose ndalimi i të gjitha aktiviteteve të lidhura me Federatën. Sanksionet mund të vendosen si për organizatat simotra ashtu edhe për bashkëpunëtorët dhe mund të aplikohen vetëm ose të kombinuara. Çdo sanksion i vendosur nga Federata nuk do të jetë pengesë për ndjekjen penale të autorit nga një gjykatë ose tribunal me juridiksion të përshtatshëm.

Individi i prekur do të informohet për çdo sanksion të vendosur, përfshirë edhe arsyen e veprimit të ndërmarrë (që do të jetë i bashkëngjitur). Gjithashtu çdo individ tjetër që Paneli Disiplinor dhe/ose udhëheqësi i caktuar për çështje të sigurisë e konsideron të përshtatshëm mund të informohet për vendimin.

Në përputhje me rregulloret e brendshme, çdo proces disiplinor i ndërmarrë nga Federata do të jetë i hapur dhe do të sfidohet nga procesi ankues. Ne do të sigurohemi që të gjithë të përfshirët të marrin mbështetjen e nevojshme.

8. Mbështetja

Në bazë të kërkesës së parashtruar, mbështetja e specializuar do të jetë në dispozicion për këdo që është prekur nga zbulimi i çështjes së mbrojtjes, incidenti, ose shqetësimi (i dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët gjatë dhe pas një incidenti, akuze, ose ankese. Kjo përfshin njerëzit e prekur drejtpërdrejt ose tërthorazi në një incident, akuzë, ose ankese, duke përfshirë, por jo vetëm, të akuzuarit, të prekurit dhe çdo individ të lidhur me përgjegjësi të veçantë për mbrojtje. Kontaktoni udhëheqësin e caktuar për çështjen e mbrojtje për të pasur qasje në mbështetje.

I gjithë stafi dhe vullnetarët me përgjegjësi të veçantë për mbrojtje do të kenë qasje në mbështetje të rregullt dhe të specializuar shtesë. Federata do të rishikojë nëse duhet të mbajë një regjistër të ankesave për çështjet e të drejtave të njeriut të individëve që punojnë me fëmijët.

9. Rekrutimi më i sigurt

Federata dhe të gjithë anëtarët e saj duhet të ndjekin Politikën e Sigurt të Rekrutimit dhe Përzgjedhjes për të siguruar që ata të rekrutojnë vetëm njerëz të përshtatshëm. Federata do të rishikojë nëse duhet të mbajë një regjistër të ankesave për çështjet e të drejtave të njeriut të individëve që punojnë me fëmijët.

Kontrollet para rekrutimit

Aty ku lejohet ligjërisht, të gjithë bashkëpunëtorët që angazhohen me fëmijë dhe të rinj, qofshin me pagesë apo vullnetarë, duhet t'i nënshtrohen përpara emërimit kontrollit të së kaluarës kriminale, ndërsa një herë në tre vjet pas emërimit. Vendimi nëse e kaluara kriminale e individit e ndalon atë të punësohet, qoftë me pagesë ose vullnetarë, me fëmijë dhe të rinj do t'i përmbahet statutit/udhëzimeve kombëtare.

Të gjitha përshkrimet e vendit të punës duhet të përmbajnë deklarata për trajtimin e njerëzve me dinjitet, respekt, ndjeshmëri dhe drejtësi. Duhet të ndërmerren hapat e duhur për të verifikuar identitetin, kualifikimet dhe përvojën e të gjithë stafit dhe vullnetarëve.

Përpara emërimit, të gjithë bashkëpunëtorët, qofshin me pagesë apo vullnetarë dhe pavarësisht nëse kanë të drejtë apo jo t'i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës kriminale, duhet gjithashtu:

të plotësojnë formularin e vetë-deklarimit (në dispozicion në Politikën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Sigurt),

të sigurojnë të paktën dy referenca me shkrim në lidhje me karakterin/punësimin e tyre,

të intervistohen nga së paku dy përfaqësues të organizatës.

Të gjitha shpalljet për rekrutimin e bashkëpunëtorëve duhet të përcaktojnë se pozita përfshin punën me fëmijë dhe të rinj dhe i nënshtrohet kontroleve të mësipërme (p.sh. intervista, kontrolli i së kaluarës kriminale, vetë-deklarimi, referenca, kontrollet e identitetit, kontrollet e kualifikimit). I gjithë stafi i ri dhe vullnetarët do t'i nënshtrohen një periudhe provuese ose testuese prej 6 muajsh.

Nëse del ndonjë informatë në lidhje me këtë proces, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes duhet të bëjë një vlerësim rreziku për të përcaktuar përshtatshmërinë e individit për rolin.

Në lidhje me emërimin

Të gjithë bashkëpunëtorët e rinj, qofshin me pagesë ose vullnetarë, duhet t'i nënshtrohen trajnimit në vend të punës sa më shpejt të jetë e mundur (zakonisht brenda 6 javësh nga fillimi i punës së re). Ky proces duhet t'i familjarizojë ata me të gjitha aspektet e rëndësishme të mjedisit dhe rolit të tyre të ri, duke përfshirë politikën mbrojtëse të Federatës dhe politikat dhe procedurat shoqëruese.

Të gjithë bashkëpunëtorët e rinj, qofshin me pagesë apo vullnetarë, duhet t'i nënshtrohen trajnimeve për politikat dhe procedurat e mbrojtjes brenda 6 javësh nga fillimi i punës së tyre të re.

10.

Kërkesat për trajnim

Pjesëmarrja në trajnimin për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre është e detyrueshme çdo tre vjet për të gjithë anëtarët, qofshin me pagesë ose vullnetarë. Bashkëpunëtorët me përgjegjësi të veçantë për çështjet e mbrojtjes do të kenë gjithashtu qasje në trajnimet e rregullta dhe të specializuara shtesë.

Federata duhet të mbajë një regjistër të gjithë stafit që ka kryer trajnimin. Përgjegjësia për mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave të trajnimit i takon Komitetit Ekzekutiv/shefit ekzekutiv të Federatës.

Bashkëpunëtorët që janë anëtarë të ekuipazhës së sportistëve

Të gjithë bashkëpunëtorët që janë anëtarë të ekuipazhës së sportistëve duhet t'i nënshtrohen trajnimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve që së paku përfshijnë:

- përkufizimet dhe shembujt e dhunës, abuzimit, dëmtimit dhe praktikave të këqija në basketboll,
- shkallën e përhapjes së dhunës dhe abuzimit në sport/basketboll (kur janë në dispozicion),
- treguesit e dhunës dhe abuzimit,
- faktorët e rrezikut për dhunën dhe abuzimin në basketboll/sport,

- përgjegjësitë e tyre minimale për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre,
- procedurat e raportimit për zbulimet, incidentet, ose shqetësimet (e dyshuara) për dëmtim ose praktikë të dobët brenda dhe jashtë Federatës,
- qasje bazuar në informatën për traumën për menaxhimin e zbulimeve,
- mbështetja në dispozicion për ta gjatë dhe pas një zbulimi, incidenti ose shqetësimi për dëmtim ose praktikë të dobët dhe si mund t'i qasen mbështetjes,
- kodi i sjelljes i Federatës për trajnerët/ kodi i sjelljes për zyrtarët/ kodi i sjelljes për anëtarët e ekuipazhës së sportistëve.

Bashkëpunëtorët e tjerë që nuk janë pjesë e ekuipazhës së sportistëve dhe nuk janë trajnerë

Të gjithë bashkëpunëtorët që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejtë në trajnimin ose mbështetjen e sportistëve, si stafi i lartë i Federatës, duhet t'i nënshtrohen trajnimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve që së paku përfshijnë:

- përgjegjësitë e tyre dhe të organizatës së tyre për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre dhe pasojat e dështimeve
- përkufizimet dhe shembujt e dhunës, abuzimit, dëmtimit dhe praktikave të këqija në basketboll,
- shkallën e përhapjes së dhunës dhe abuzimit në sport/basketboll (kur janë në dispozicion),
- treguesit e dhunës dhe abuzimit,
- faktorët e rrezikut për dhunën dhe abuzimin në basketboll/sport,
- procedurat e raportimit për zbulimet, incidentet, ose shqetësimet (e dyshuara) për dëmtim ose praktikë të dobët brenda dhe jashtë Federatës,
- mbështetja në dispozicion për ta gjatë dhe pas një zbulimi, incidenti ose shqetësimi për dëmtim ose praktikë të dobët dhe si mund t'i qasen mbështetjes.

Sportistët/lojtarët

Sportistëve/lojtarëve, përfshirë edhe fëmijët dhe të rinjtë, duhet t'u ofrohet trajnim i përshtatshëm dhe në përputhje me moshën për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre dhe/ose informacion me shkrim që së paku mbulon:

- përkufizimet dhe shembujt se si dhuna, abuzimi, dëmtimi dhe praktikat e këqija manifestohen në basketboll,
- të drejtat e tyre, përfshirë edhe të drejtën për pjesëmarrje/ për të ngritur zërin për të gjitha çështjet që i prekin ata dhe si mund ta bëjnë këtë,
- si mund të raportojnë incidente ose shqetësime për dëmtim ose praktikë të dobët që përfshijnë veten ose të tjerët brenda dhe jashtë Federatës,
- çfarë do të ndodhë pas një zbulimi ose incidenti,
- mbështetjen në dispozicion për ta gjatë dhe pas një zbulimi, incidenti ose shqetësimi për

- dëmtim ose praktikë të dobët dhe si mund t'i qasen mbështetjes,
- këshillat se si mund ta mbajnë veten të sigurt në sport,
- kodin e sjelljes së Federatës për fëmijët dhe të rinjtë / kodin e sjelljes për lojtarët.

Prindërit kujdestarët

Prindërit/kujdestarët duhet t'i nënshtrohen trajnimit për mbrojtjen e fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe/ose informacion me shkrim që së paku mbulon:

- përkufizimet dhe shembujt se si dhuna, abuzimi, dëmtimi dhe praktikat e këqija manifestohen në basketboll,
- të drejtat e fëmijëve dhe si aplikohen ato në sport,
- si mund të raportojnë incidentet ose shqetësimet e dëmtimit ose praktikës së dobët që përfshin një fëmijë brenda dhe jashtë Federatës;
- çka do të ndodhë pas një zbulimi apo incidenti,
- mbështetjen në dispozicion për ta dhe/ ose fëmijën e tyre gjatë dhe pas një zbulimi, incidenti ose shqetësimi për dëmtim ose praktikë të dobët dhe si mund t'i qasen mbështetjes,
- kodet e sjelljes së Federatës për prindërit / trajnerët / fëmijët dhe të rinjtë.

11.

Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha aktiviteteteve të mbikëqyrura nga një bashkëpunëtor (anëtar) duhet t'iu bëhet vlerësimi i rrezikut. Përgjegjësi (i rrituri) për aktivitetin bën vlerësimin e rrezikut para çdo aktiviteti, duke përdorur Formularin e Vlerësimit të Rrezikut (shih Shtojcën).

Aktivitetet që duhet të vlerësohen për rrezik përfshijnë, por jo vetëm: seancat e trajnimit dhe garat, transportin e fëmijëve dhe të rinjve për në/ nga aktivitetet, akomodimin/vizitat larg shtëpisë. Personi (i rrituri) përgjegjës për plotësimin e vlerësimit të rrezikut ruan kopjet e vlerësimeve në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së.

Nëse rreziqet vlerësohen të jenë shumë të rëndësishme, atëherë aktiviteti nuk duhet të vazhdojë.


12.

Puna me partnerë

Kur ekzistojnë ose krijohen lidhje, partneritete, financime ose marrëdhënie pune me organizata të tjera, Federata duhet të përdorë ndikimin e saj për të promovuar zbatimin e masave për të mbrojtur fëmijët dhe të rinjtë dhe për të respektuar të drejtat e tyre.

Të gjitha lidhjet, partneritetet, financimet dhe kriteret e marrëdhënies së punës të krijuara nga Federata duhet të përfshijnë kërkesën për mbrojtjen që adresohet përmes miratimit të politikave, procedurave dhe praktikave të përshtatshme. Së paku kjo duhet të përfshijë sigurimin se të gjithë bashkëpunëtorët (anëtarët) miratojnë një politikë mbrojtjeje që është në përputhje me atë të Federatës.

Federata duhet të promovojë në mënyrë aktive mbrojtjen brenda të gjitha marrëveshjeve të punës në partneritet dhe duhet të kërkojë që organizatat partnere të respektojnë këtë Politikë të Mbrojtjes dhe politikat dhe procedurat përkatëse shoqëruese.



13.

Monitorimi, vlerësimi & rishikimi

Kjo politikë e mbrojtjes dhe të gjitha politikat dhe procedurat përkatëse shoqëruese duhet të rishikohen në intervale të përcaktuara prej të paktën çdo 3 vjet dhe të rishikohen në frymën e ndryshimeve në rolin ose strukturën e Federatës, ndryshimet në legjislacion dhe udhëzime, ose në frymën e të mësuarit nga raste të rëndësishme. Ne pranojmë që gjatë rishikimit të politikës do të konsultohemi me sportistët, përfshirë edhe fëmijët dhe të rinjtë, prindërit/kujdestarët e tyre dhe të gjithë bashkëpunëtor dhe grupet e interesit.

Duhet të ekzistojnë marrëveshje në fuqi që bëjnë monitorimin e përputhshmërisë së bashkëpunëtorëve me këtë Politikë të Mbrojtjes dhe të gjitha politikat dhe procedurat përkatëse shoqëruese.

Federata është e përkushtuar të rishikojë së paku çdo 3 vjet të gjitha çështjet e zbuluara të mbrojtjes, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikave të dobëta të trajtuara dhe gjetjet gjatë procesit të rishikimit do t'i përfshijë në trajnimet, politikat dhe/ose procedurat tona.

14.

Vegëzat për informata të tjera

Ann Craft Trust – seria e seminareve: kulturë e sigurt, sport më i sigurt

<https://www.anncrafttrust.org/resources/online-seminar-series/>

Futbolli në Angli - kursi i ndërgjegjësimit të mbrojtjes për prindërit dhe kujdestarët

<https://learn.englishfootball.com/courses/safeguarding/safeguarding-awareness-for-parents-and-carers>

Politika e Mbrojtjes e FIBA-s

<https://www.fiba.basketball/en/Module/85132837-66aa-4ff3-a063-8cdfe44ea14d/59679204-d659-4349-8410-afea505e7e0c>

i-Protect – kursi për mbrojtje online për individët në sport

<https://www.safesportinternational.com/i-protect/individual-route/>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – burime të sigurta sportive

<https://olympics.com/athlete365/safe-sport/>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – seria e videove: imazhi i trupit të shëndetshëm i sportistëve

<https://olympics.com/ioc/healthy-body-image>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – burimet për mbështetje të shëndetit mendor

<https://olympics.com/athlete365/mentally-fit/>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – deklaratë konsensusi për ngacmimin dhe abuzimin në sport

https://olympics.com/athlete365/app/uploads/2020/12/IOC-Consensus-Statement_Harassment-and-abuse-in-sport-2016.pdf

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar –kursi për mbrojtjen e gjërave themelore për fëmijët dhe të rinjtë

<https://olympics.com/athlete365/courses/youth-olympic-games-athletes/>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – kurs interaktiv mbi sjelljen e pranueshme/të papranueshme në sport

<https://drawtheline.olympics.com/#eyJ1c2VyX2lkIjoi-YzczU3BDM1J3WkdFSTRQWiIsbnN1cnJlbnRfc2NlbnUiOiJx-dWVzdGlvbjEifQ==>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – kursi interaktiv mbi shëndetin e sportisteve

<https://www.olympicresources.com/Home/Welcome>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar – fletët e të dhënave mbi rolet dhe përgjegjësitë e mbrojtjes të anëtarëve të ekuipazhës së sportistëve

<https://olympics.com/athlete365/safe-sport/safe-sport-entourage-factsheet/>

Komiteti Olimpik Ndërkombëtar –seria e Webinar-eve për sport të sigurt

<https://olympics.com/athlete365/safe-sport/ioc-safe-sport-webinar-series-for-national-olympic-committees/> and

[\[ing-webinar-series-for-international-federations\]\(#\)

Masat e mbrojtjes ndërkombëtare për fëmijët në sport

<https://www.unicef.org.uk/wp-content/uploads/2014/10/International-Safeguards-for-Children-in-Sport-version-to-view-online.pdf>

Kyniska Advocacy – video për rritjen e ndërgjegjësimit për një sërë temash të sportit të sigurt

<https://www.kyniskaadvocacy.com/videos-resources>

NSPCC mbrojtja e fëmijëve në njësinë sportive – Webinar për mbrojtjen e LGBTQ+ të rinjtë në sport

<https://thecpsu.org.uk/resource-library/webinars/safeguarding-lgbtq-plus-young-people-in-sport/>

NSPCC mbrojtja e fëmijëve në njësinë sportive – aktivite kundër bullizmit për fëmijët në sport

<https://thecpsu.org.uk/resource-library/tools/anti-bullying-activities/>

NSPCC mbrojtja e fëmijëve në njësinë sportive – Webinar mbi çrregullimet e të ngrënit dhe të ushqyerit e çrregullt në sport

<https://thecpsu.org.uk/resource-library/webinars/eating-disorders-in-sport/>

NSPCC mbrojtja e fëmijëve në njësinë sportive – podcast mbi menaxhimin e peshës, imazhin e trupit dhe çrregullimet e të ngrënit në sport

<https://thecpsu.org.uk/resource-library/podcasts/ep12-16-body-image-weight-management-and-disordered-eating-in-sport/>](https://olympics.com/ioc/safe-sport/ioc-athlete-safeguard-</p></div></div><div data-bbox=)

NSPCC mbrojtja e fëmijëve në njësinë sportive – Ud-hëzime për reagim ndaj akuzave që kanë ndodhur në të kaluarën

<https://thecpsu.org.uk/media/446109/responding-to-reports-of-non-recent-abuse.pdf>

Ushtria e të mbijetuarve – të kuptojmë traumën

<https://thearmyofsurvivors.org/trauma/>

Ushtria e të mbijetuarve – adoptimi i qasjes së bazuar në informatë për traumë

<https://thearmyofsurvivors.org/trauma-informed/>

Ushtria e të mbijetuarve – të njohim abuzimin në sport

<https://thearmyofsurvivors.org/wp-content/uploads/2022/03/Recognizing-Abuse.pdf>

Universiteti “The Open” – kurset themelore për çështje të mbrojtjes

<https://www.open.edu/openlearncreate/course/view.php?id=11403>

Shoqata Botërore e Lojtarëve/ Uni Global Union – krijimi i organeve efektive dhe të sigurta në sport

https://thearmyofsurvivors.org/wp-content/uploads/2022/12/1_Safe-Sport-Entity-Guidance_final.pdf

SHTOJCA

Abuzimi	“Trajtimi i dikujt me dhunë, mungesë respekti, mizori, dëmtim ose forcë, duke filluar nga mosrespektimi deri te shkaktimi dikujt dhimbje fizike ose mendore” (FIBA, 2022, f.2). Abuzimi mund të klasifikohet në 4 lloje (shpesh gërshetohen): 1) Dhuna/abuzimi fizik, 2) dhuna/abuzimi psikologjik ose emocional, 3) dhuna/abuzimi seksual, 4) shpërfillja.”
Ekuipazhi i sportistit	Ekipi që qëndron pas sportistëve, përfshirë edhe agjentët, sponsorët, mjekët, fizioterapistët, këshilltarë dhe partnerë të tjerë shëndetësorë dhe mbështetës.
Bullizmi	Sjellje e përsëritur ose e ashpër që synon të frikësojë ose mërzisë dikë dhe/ose t'i bëjë ata të mos ndihen komod ose të pasigurt, për shembull, përdorimi i emrave nënçmues, përgjashtimi ose izolimi, përhapja e thashethemeve, turpërimi i dikujt në publik ose para bashkëmoshatarëve, kërcënimi për të shkaktuar dëm, fizikisht për të lënduar dikë ose dëmtuar pasurinë e tij ose kombinim i këtyre veprimeve” (FIBA, 2002). Mund të ndodhë personalisht ose në internet.
Fëmija	Çdo person nën moshën 18 vjeç.
Të drejtat e fëmijëve	Nëngrupi i të drejtave të njeriut që lidhen posaçërisht me fëmijët, siç parashikohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 1989)
Shfrytëzimi seksual i fëmijëve	Një formë e abuzimit seksual të fëmijëve që ndodh “kur një individ ose grupe njerëzish përfitojnë nga një çekuilibër pushteti për të detyruar, manipuluar ose mashtruar një fëmijë në aktivitet seksual në këmbim të diçkaje që viktimja ka nevojë ose dëshiron dhe/ose për përfitime financiare, ose edhe pozita në avantazh e autorit të veprës ose lehtësuesit. Viktimja mund të jetë shfrytëzuar seksualisht edhe nëse aktiviteti seksual duket me pëlqim. Shfrytëzimi seksual i fëmijëve mund të bëhet edhe nëpërmjet përdorimit të teknologjisë” (FIBA, 2022, f.8).
Trajneri	Çdo instruktor ose trajner, qoftë me pagesë ose punë vullnetare, në një mjedis sportiv
Diskriminimi	“... trajtim i paarsyeshëm, i pabarabartë lidhur me një ose më shumë arsye të ndaluara” (për shembull, ‘raca’, ngjyra, seksi, feja, orientimi seksual, identiteti gjinor) (Këshilli i Evropës, 2018, f. 7).
- të përmbahen nga përfshirja në mashtrime të qëllimshme që synojnë të manipulojnë rezultatin e një gare dhe/ose të mos ofrojnë ose pranojnë çfarëdo ryshfeti që ka për qëllim manipulimin e rezultatit të garës,

- të jenë në gjendje të njohin dhe të pranojnë se kur duhet t'i referojnë ose rekomandojnë lojtarët tek trajnerët ose strukturat e tjera,
- të mos tolerojnë që lojtarët, trajnerët, prindërit dhe/ose zyrtarët të përdorin gjuhë ose gjeste fyese, seksiste ose raciste,
- të vijnë me kohë në palestër për të caktuar rrjedhën e aktiviteteve dhe për të garantuar sigurinë (d.m.th., të bëjnë vlerësimin e rrezikut),
- të jenë të qëndrueshëm, objektiv, të paanshëm dhe të i sjellshëm në zbatimin e rregullave të lojës,
- të marrin gjithmonë parasysh interesat më të mira të lojës, duke përfshirë kur shprehin publikisht një opinion për lojën ose ndonjë aspekt të veçantë të saj, përfshirë edhe për personat e tjerë të përfshirë në lojë,
- të inkurajojnë fëmijët që të japin mendimin e tyre për të gjitha çështjet që i prekin ata dhe t'i dëgjojnë ata,
- të përmbahen nga kritikrat publike ndaj trajnerëve apo zyrtarëve të tjerë,
- asnjëherë të mos rekrutojnë, qoftë haptazi apo fshehurazi, sportistë që veçse janë duke u stërvitur (nëse iu afrohet një sportist që veçse është duke u stërvitur, t'i referojnë ata menjëherë te trajneri aktual),
- të mos qëndrojnë të vetëm me sportistët e rinj (nën 18 vjeç) ose të rriturit e cënueshëm, përveç nëse kjo ndodhë në sy të të rriturve të tjerë,
- të përmbahen nga krijimi i miqësisë të çfarëdo lloji dhe të mos pranojnë të miqësohet në mënyrë të tillë që mund të konsiderohet e tepërt,
- të sigurohen se prindërit/kujdestarët janë të informuar dhe kanë dhënë pëlqimin paraprak që të largoheni me fëmijën e tyre ose të rriturin e cënueshëm nga palestra,
- të pranojnë këshillat e Federatës që zyrtarët e ndeshjeve të mos udhëtojnë të vetëm me fëmijët dhe/ose të rriturit e cënueshëm. Po ashtu, të pranojnë këshillat e Federatës që kurdo që është e mundur të kenë me vete një të rritur tjetër nëse udhëtojnë ose qëndrojnë gjatë natës në një ngjarje me një fëmijë ose të rritur të cënueshëm,

- të mos e ftojnë kurrë një fëmijë ose të rritur të cënueshëm vetëm në shtëpinë ose dhomën e tij të hotelit,
- të mos përfshihen kurrë në sjellje të dhunshme ose kërcënuese,

Si **trajner**, ne e kuptojmë që ju keni të drejtë të:

- të shijoni kohën që kaloni me ne dhe të keni mbështetjen e nevojshme në rolin tuaj;
- të informoheni për procedurat tona të mbrojtjes dhe raportimit dhe çfarë duhet të bëni nëse diçka nuk është në rregull;
- të keni qasje në trajnime të vazhdueshme për të gjitha aspektet e rolit tuaj;
- të dëgjoheni;
- të përfshihen dhe të kontribuoni në vendimet brenda Federatës ose aktivitetit;
- t'ju respektojmë dhe trajtojmë siç duhet;
- të ndiheni të mirëpritur, të vlerësuar dhe të mos gjykoheni për shkak të moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, kombësisë, kulturës, etnisë, përkatësisë sociale, fesë ose besimit, opinionit politik dhe nivelit të aftësisë ose paaftësisë tuaj;
- të mbroheni nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi;
- të keni mbështetje për të zgjidhur çdo konflikt.

Unë e kuptoj se nëse nuk e respektoj Kodin, mund të kem bërë shkelje të kushteve përkatëse dhe mund t'iu nënshtrohem masave dhe sanksioneve disiplinore të Federatës në përputhje me politikën e tyre disiplinore.

Shkeljet e përsëritura të këtij Kodi mund të rezultojnë që Federata të marrë masa disiplinore kundër jush me përfshirjen e organeve drejtuese, si dhe mund të sjellë shkarkimin nga organizata.

Nënshkrimi i trajnerit:

Emri dhe mbiemri i trajnerit (me shkronja të shtypit):

Data:

Kodi i sjelljes për zyrtarët

Shënim: Termi “fëmijët” ose “fëmija” përshkruan të gjithë personat nën moshën 18 vjeçe.

Qëllimi i Kodit të Sjelljes është të sigurojë një mjedis pozitiv dhe të sigurt brenda programeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (‘Federata’), duke ua bërë të ditur të gjithë individëve se nga ta pritet që të sillen në pajtueshmëri me rregullat e Federatës. Ky Kod i Sjelljes është pjesë përbërëse e politikës së Federatës për mbrojtje, të cilës duhet t’i përmbahen të gjithë bashkëpunëtorët. Ai duhet të përdoret me të gjitha politikat, procedurat ose standardet e njohura të tjera të Federatës.

Me nënshkrimin e këtij Kodi të Sjelljes, zyrtarët e caktuar (si gjyqtarët..., etj.) pajtohen që:

- të respektojnë të gjitha rregullat, politikat dhe procedurat e Federatës,
- të kenë kualifikimet e duhura për nivelin ku angazhohen si zyrtar dhe të vazhdojnë zhvillimin personal dhe profesional përmes trajnimeve dhe veprimtarive të vazhdueshme profesionale,
- para regjistrimit në Federatë, duhet të sigurojnë që të kenë kryer trajnimin për mbrojtjen dhe të drejtat e njeriut dhe të raportojnë menjëherë te udhëheqësi i caktuar i Federatës për çështje të mbrojtjes të gjitha incidentet dhe shqetësimet (e mundshme),
- të paraqesin në formularin e deklarimit të gjitha rastet e disiplinimit, shkarkimit, paralajmërimit, qortimit ose dënimit për ndonjë vepër që kanë të bëjnë me fëmijët/të rinjtë/të rriturit e cënueshëm dhe të dorëzojnë atë te udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes,
- të bashkëpunojnë me udhëheqësin e caktuar për çështje të mbrojtjes dhe/ose autoritetet ose agjencitë përkatëse kur kërkohet të zbulojë ndonjë dokument, të ofrojnë ndonjë provë ose informacion tjetër ose të japin deklaratë me shkrim në lidhje me ndonjë hetim nga udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes ose ndonjë autoritet ose

agjenci tjetër,

- të bëjnë çdo gjë që është e mundur për t’u përgatitur sa më mirë për një ndeshje, si fizikisht ashtu edhe mendërisht. Në nivel fizik, zyrtarët duhet të jenë në gjendje të mbajnë ritmin e lojës moderne, të jenë vigjilentë dhe të qëndrojnë shumë afër një situatë për të marrë vendime të sakta nga vendet e caktuara që i mbulojnë në parket,
- të mos pranojnë të caktohen për të gjykuar një ndeshje nëse nuk janë plotësisht të aftë fizikisht ose mendërisht për të gjykuar në atë ndeshje (për shkak të sëmundjes, lëndimit, për arsye familjare apo të tjera),
- të informojnë drejtpërdrejt personin ose organizatën përgjegjëse nëse për arsye të caktuara nuk janë në gjendje të gjykojnë ndeshjen ose ndeshjet,
- të përmbahen nga krijimi i miqësisë të çfarëdo lloji dhe të mos pranojnë të miqësohen në mënyrë të tillë që mund të konsiderohet e tepruar,
- të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e çdo pjesëmarrësi pavarësisht nga mosha, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, kombësia, kultura, etnia, përkatësia social, feja ose besimi, opinioni politik dhe niveli i aftësisë ose paaftësisë,
- t’i inkurajojë fëmijët që të japin mendimin e tyre për të gjitha çështjet që i prekin ata, si dhe të dëgjojnë ata,
- të sillen në atë mënyrë të përshtatshme që merr parasysh të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen dhe sigurinë personale dhe të të tjerëve,
- të jenë të ndershëm dhe të paanshëm në çdo kohë, pavarësisht nga ekipet, lojtarët ose zyrtarët e ekipit të përfshirë në ndeshje,
- të mos ngurrojnë të marrin vendime. Zyrtarët duhet të jenë të drejtë dhe të vendosur dhe duhet t’i rezistojnë çfarëdo ndikimi dhe protestave të lojtarëve, zyrtarëve të ekipeve ose publikut,
- të jenë të qëndrueshëm, objektiv, të paanshëm dhe të sjellshëm në zbatimin e rregullave të lojës,
- të marrin gjithmonë parasysh interesat më të mira të lojës, duke përfshirë kur shprehin

publikisht një opinion për lojën ose ndonjë aspekt të veçantë të saj, përfshirë edhe për pjesëmarrësit e tjerë në lojë,

- të mos tolerojnë që lojtarët, trajnerët, prindërit dhe/ose zyrtarët të përdorin gjuhë ose gjeste fyese, seksiste ose raciste,
- të marrin parasysh mbrojtjen e lojtarëve duke iu përmbajtur rregullave të lojës,
- të tregojnë respektin e duhur kur flasin me lojtarët, edhe në rast të shkeljeve të mundshme,
- Në raport, zyrtarët duhet të shtjellojnë faktet dhe nuk duhet të përpiqen të arsyetojnë ndonjë vendim,
- të përmbahen nga kritikrat publike ndaj zyrtarëve të tjerë,
- të ndihmojnë në zhvillimin e zyrtarëve me më pak të përvojë,
- të inkurajojnë të dyja ekipet të luajnë brenda rregullave dhe frymës së lojës,
- të trajtojnë pjesëmarrësit me respekt, edhe kur respekti nuk është i dyanshëm,
- kur ju jepet mundësia, të përgëzojnë të dyja ekipet për lojën e mirë,
- të tregojnë durim dhe mirëkuptim ndaj lojtarëve që veçse janë duke mësuar për lojën,
- të respektojnë lojtarët dhe zyrtarët e ekipit,
- të demonstrojnë në çdo ndeshje njohuri të mëdha për rregullat përkatëse të garës,
- të ruajnë kufijtë profesionalë me të gjithë pjesëmarrësit,
- të shkojnë në ndeshje në kohë,
- të pranojnë këshillat e Federatës që zyrtarët e ndeshjeve të mos udhëtojnë të vetëm me fëmijët dhe/ose të rriturit e cënueshëm. Po ashtu, zyrtarët duhet të zbatojnë këshillat e Federatës që kurdo që është e mundur të udhëtojnë me një të rritur tjetër nëse udhëtojnë ose qëndrojnë gjatë natës në një ngjarje me një fëmijë ose të rritur të cënueshëm,
- të mos e ftojnë kurrë një fëmijë vetëm në shtëpinë ose dhomën e tyre të hotelit,
- të vishen siç duhet dhe të paraqiten me uniformën zyrtare për lojëra dhe gara,

- të promovojnë sportin dhe të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të parandaluar që sportit t’i dalë emri i keq,
- të mos përdorin kurrë gjuhë ose gjeste të pahijshme,
- të mos përfshihen kurrë në sjellje të dhunshme ose kërcënuese.

Si **zyrtar i caktuar**, ne e kuptojmë që ju keni të drejtë për të:

- të shijoni kohën që kaloni me ne dhe të keni mbështetjen e nevojshme në rolin tuaj;
- të informoheni për procedurat tona të mbrojtjes dhe raportimit dhe çfarë duhet të bëni nëse diçka nuk është në rregull;
- të keni qasje në trajnime të vazhdueshme për të gjitha aspektet e rolit tuaj;
- të dëgjoheni;
- të përfshihen dhe të kontribuoni në vendimet brenda Federatës ose aktivitetit;
- t’ju respektojmë dhe trajtojmë siç duhet;
- të ndiheni të mirëpritur, të vlerësuar dhe të mos gjykoheni për shkak të moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, kombësisë, kulturës, etnisë, përkatësisë sociale, fesë ose besimit, opinionit politik dhe nivelit të aftësisë ose paaftësisë tuaj;
- të mbroheni nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi;
- të keni mbështetje për të zgjidhur çdo konflikt.

Unë e kuptoj se nëse nuk e respektoj Kodin, sjellja ime mund të jetë në kundërshtim me kushtet përkatëse dhe mund t’iu nënshtrohem masave dhe sanksioneve disiplinore të Federatës në përputhje me politikën e saj disiplinore.

Shkeljet e përsëritura të këtij Kodi mund të rezultojnë në marrjen e masave disiplinore kundër jush me përfshirjen e organeve drejtuese të Federatës, si dhe mund të sjellin shkarkimin nga organizata.

Nënshkrimi i zyrtarit:

Emri dhe mbiemri i zyrtarit (me shkronja të shtypit):

Data:

Shënim: në Kod, termi ‘prindër’ u referohet në përgjithësi prindërve dhe kujdestarëve. Termi ‘fëmijët’ ose ‘fëmija’ përkthyer çdo person nën moshën 18 vjeç.

Qëllimi i Kodit të Sjelljes është të sigurojë një mjedis pozitiv dhe të sigurt brenda programeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (‘Federata’), duke ua bërë të ditur të gjithë individëve se nga ta pritet që të sillen në pajtueshmëri me rregullat e Federatës. Ky Kod i Sjelljes është pjesë përbërëse e politikës së Federatës për mbrojtje, të cilës duhet t’i përmbahen të gjithë prindërit dhe kujdestarët. Ai duhet të përdoret me të gjitha politikat, procedurat ose standardet e njohura të tjera të Federatës.

Si prindër të një fëmije/të rrituri të cënueshëm që merr pjesë në një aktivitet me Federatën, presim që:

- ✓ të siguroheni se fëmija juaj/i rrituri i cënueshëm ka pajisjet e duhura për stërvitje/ushtrime, si dhe ushqim dhe pije të mjaftueshme,
- ✓ të siguroheni që fëmija juaj/i rrituri i cënueshëm shkon me kohë në stërvitje/ushtrime dhe ju shkon ta merrni nga aty sapo t’i kryejë ato,
- ✓ na njoftoni nëse vonoheni ose nëse fëmija juaj/i rrituri i cënueshëm shkon në shtëpi me dikë tjetër,
- ✓ të plotësoni të gjitha formularët e pëlqimit, kontaktit dhe mjekësor dhe na përditësoni menjëherë nëse ndryshon diçka,
- ✓ të keni raporte të mira me trajnerin e fëmijës tuaj/të rriturit të cënueshëm dhe të bisedoni sa më shumë që të mundeni për zhvillimin e tij/saj,
- ✓ të flisni me ne nëse keni ndonjë shqetësim për çdo aspekt të përfshirjes së fëmijës suaj/të rriturit të cënueshëm – duam të dëgjojmë nga ju!

Për të mbështetur fëmijën tuaj/të rriturit të cënueshëm në aktivitetet e Federatës, dëshirojmë që të veproni si më poshtë:

- ✓ të mësoni rreth sportit dhe sa është i rëndësishëm për fëmijën/të rriturin e cënueshëm tuajin,
- ✓ të ndani kohë dhe të bisedoni me fëmijën tuaj/të rriturin e cënueshëm tuajin dhe çka dëshironi të arrini përmes sportit,
- ✓ të mos harroni se fëmijët/të rriturit e cënueshëm përfitojnë shumë nga pjesëmarrja në sport, si krijimi i miqësive, stërvitjet/ushtrime dhe zhvillimi i aftësive. Pjesëmarrja nuk ka të bëjë vetëm me fitoret dhe humbjet,
- ✓ t’ia vini veshin nëse fëmija juaj/të rriturin e cënueshëm tuajin thotë se nuk do të bëjë diçka,
- ✓ të silleni siç duhet jashtë parketit – inkurajoni fëmijët/të rriturit e cënueshëm, brohoritni “të lumtë” dhe tregoni fëmijës suaj se jeni krenar me atë që po e bëjnë,
- ✓ të mos harroni se reagimet dhe sjellja juaj ndikon jo vetëm te fëmija juaj/i rrituri i cënueshëm, por edhe te të tjerët,
- ✓ të inkurajoni fëmijën tuaj/të rriturin e cënueshëm të respektojë dhe të mirëpresë dallimet në ekip,
- ✓ të jeni shembull kur bëhet fjalë për sjellje pozitive jashtë parketit ose dhe të bëheni shembull për prindërit e tjerë dhe për ne,
- ✓ të pranoni ndarjen e drejtësisë së gjyqtarit dhe të mos hyni në parket.
- ✓ të jeni të përgjegjshëm në përdorimin e mediave sociale kur të tregoni se çka po ndodh në Federatën ose aktivitetin dhe të silleni në rrjete ashtu siç do të sillleshit edhe kur të takoheni me dikë sy më sy,
- ✓ të mbani një mjedis sportiv pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit në të cilin nuk lejohet droga, duhani, alkooli dhe gjuha dhe gjestet e pahijshme dhe të përmbaheni nga përdorimi i tyre në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e Federatës,
- ✓ të flisni me fëmijën tuaj/të rriturin e cënueshëm që të bëhet sportist me etiketë të mirë dhe t’i merr gjërat në mënyrë sportive,
- ✓ të inkurajoni fëmijën tuaj/të rriturin e

cënueshëm të luajë sipas rregullave, ✓ të ndihmoni fëmijën tuaj/të rriturin e cënueshëm të kuptojë dhe të respektojë Kodin e Sjelljes.

Si prind, ne e kuptojmë se ju keni të drejtë që:

- ✓ të siguroheni se fëmija juaj/i rrituri i cënueshëm është i mbrojtur gjatë kohës që është nën kujdesin tonë dhe ka qasje në të gjitha politikat dhe procedurat tona;
- ✓ të dini kush është udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes dhe të keni të dhënat kontaktuese të tij/saj
- ✓ të përshiheni dhe kontribuoni në vendimet brenda Federatës ose aktivitetit,
- ✓ të dini se çfarë trajnimesh dhe kualifikimesh kanë stafi dhe vullnetarët tanë,
- ✓ të informoheni për problemet ose shqetësimet që kanë të bëjnë me fëmijën tuaj/të rriturin e cënueshëm,
- ✓ të dini çfarë ndodh nëse ka ndodhur një aksident ose është lënduar dikush.
- ✓ të informoheni nëse fëmija juaj/të rriturin e cënueshëm është lënduar dhe të shikoni të dhënat e ndonjë aksidenti të mundshëm,
- ✓ të jepni pëlqimi juaj për çdo gjë jashtë formularit tonë fillestar të pëlqimit, si p.sh. leja për të shkuar në udhëtime ose që të fotografojmë ose t’i përdorim fotot e fëmijës suaj/të rriturit të cënueshëm,
- ✓ të dëgjohet zëri juaj dhe të merret veprim për të gjitha shqetësimet tuaja për ndonjë aspekt të mirëqenies, shëndetit dhe/ose sigurisë së fëmijës/të rriturit të cënueshëm.

Kërkojmë nga të gjithë prindërit të sillen siç duhet dhe sipas kërkesave të përcaktuara në Kod. Nëse prindërit sillen në mënyrë që bie ndesh me ndonjë nga pikat e përcaktuara më sipër, ne do ta adresojmë atë problem me prindërit sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të synojmë ta zgjidhim atë.

Shkeljet e përsëritura të Kodit mund të rezultojnë që t’u kërkohet prindërve të mos marrin pjesë në lojëra nëse ardhja e tyre në aktivitet konsiderohet si rrezik për mirëqenien dhe kënaqësinë e fëmijëve/të rriturve të cënueshëm.

Shkeljet e përsëritura të Kodit mund të rezultojnë që me keqardhje t’i kërkojmë fëmijës/të rriturit e cenueshëm të largohet përgjithmonë nga aktivitetit ose ngjarja diçka që nuk duam ta bëjmë kurrë.

Nënshkrimi i prindit:

Emri dhe mbiemri i prindit (me shkronja të shtypit):

Data:

Qëllimi i Kodit të Sjelljes është të sigurojë një mjedis pozitiv dhe të sigurt brenda programeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (‘Federata’), duke ua bërë të ditur të gjithë individëve se nga ta pritet që të sillen në pajtueshmëri me rregullat e Federatës. Ky Kod i Sjelljes është pjesë përbërëse e politikës së Federatës për mbrojtje, të cilës duhet t’i përmbahen të gjithë bashkëpunëtorët. Ai duhet të përdoret me të gjitha politikat, procedurat ose standardet e njohura të tjera të Federatës.

Si lojtar dhe si qenie njerëzore, ju keni përgjegjësi ndaj vetes, prindërve, bashkëlojtarëve dhe trajnerëve tuaj. Si lojtar që merr pjesë në sportin tonë, Federata pret që ju t’i përmbaheni Kodit për t’u siguruar që jeni në gjendje të merrni pjesë në basketboll të sigurt dhe të keni një përvojë pozitive.

Duke e nënshkruar Kodin e Sjelljes, ju pajtoheni që:

- të jeni të drejtë, të ndershëm dhe të sjellshëm ndaj të gjithë pjesëmarrësve,
- të respektoni bashkëlojtarët, ekipet e tjera, zyrtarët dhe trajnerët,
- të respektoni gjithmonë vendimet e zyrtarëve,
- të mendoni për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë tuaj dhe të pjesëmarrësve të tjerë para dhe gjatë aktivitetit të basketbollit,
- të mos përfshihen në sjellje që përbëjnë ndonjë formë dhune ose abuzimi (p.sh., dhunë fizike, seksuale ose psikologjike/ emocionale, neglizhencë, ngacmim, etj.).
- të krijoni raporte të përshtatshme me pjesëmarrësit e tjerë, stafin e ekipit dhe zyrtarët,
- të shkoni në stërvitje dhe ndeshje në kohë dhe të përgatiteni siç duhet,
- të mos përfshihen në ngacmime, nisma keqdashëse ose sfida,
- të respektoni rregullat dhe frymën e lojës,
- të pranoni vendimet e zyrtarëve pa bërë fjalë dhe pa ankesa (kapiteni i ekipit ose trajneri juaj duhet t’i parashtrojë pyetjet e nevojshme),

Kodi i sjelljes për lojtarët

- të veproni në mirëbesim dhe të tregoni nivelin më të lartë të integritetin, veçanërisht duke i respektuar parimet në vijim:
- të shmangni konfliktin e interesit,
- të luftoni çfarëdo forme të ryshfetit dhe të ndërmerrni masa të vendosura dhe të përshtatshme kundër çdo forme të mashtrimit ose korrupsionit në sport,
- të refuzoni çfarëdo forme të dopingut; t’ju përmbaheni kodit të WADA-s dhe të mbështetni programet e saj,
- të përmbaheni nga çfarëdo forme e vënies së bastit apo promovimit të vënies së bastit në sport
- të mos konsumoni duhan ose alkool në palestër as gjatë stërvitjeve, garave apo kur përfaqësoni vendin,
- të shfaqni një imazh pozitiv dhe profesional për veten dhe basketbollin,
- të merrni gjërat në frymë sportive – të pranoni të gjitha paraqitjet e mira, qoftë nga ekipi juaj apo nga kundërshtari,
- të promovojnë sportin dhe të ndërmarrin të gjitha hapat e mundshëm për të parandaluar që sportit t’i dalë emri i keq,
- të mos përdorni kurrë gjuhë ose gjeste të papërshtatshme,
- të mos përfshihen kurrë në sjellje të dhunshme ose kërcënuese,
- të mos bullizoni, përhapni thashetheme ose të tregoni gënjeshtër për të tjerët,
- të silleni me dinjitet kur fitoni apo kur humbisni – shtrëngoni duart me ekipin kundërshtar dhe zyrtarët në përfundim të çdo ndeshjeje
- të mos e mashtroni kurrë qëllimisht Federatën – për shembull, të falsifikoni të dhënat personale, të përdorni qëllimisht fotografinë e ndonjë personi tjetër, të përdorni qëllimisht emër tjetër nga ai që është paraqitur në dokumentacionin zyrtar si pasaporta ose certifikata e lindjes,
- të lexoni dhe të zbatoni praktikat e mira të paraqitura në politikën e Federatës për mbrojtje, të politikës të sigurisë në internet dhe asaj të mediave sociale,

- të zbatoni politikat, procedurat, udhëzimet, Kodin e Etikës dhe rregullat e garave të Federatës,
- asnjëherë të mos mashtroni apo përfaqësoni rrejshëm veten, Federatën apo sportin në ndonjë komunikim, veprim ose mundësi tjetër që mund të shihet si përfaqësim qëllimisht i rrejshëm, që ndër të tjera mund të përfshirë edhe veprim që shtrihet përtej kualifikimit për klasifikim,
- të raportoni çdo incident ose shqetësim (të mundshëm) të udhëheqësi i caktuar i Federatës për çështje të mbrojtjes të fëmijëve

Si **lojtar pjesëmarrës**, ne e kuptojmë që ju keni të drejtë:

- të shijoni kohën që kaloni me ne dhe të keni mbështetjen e nevojshme në rolin tuaj;
- të informoheni për procedurat tona të mbrojtjes dhe raportimit dhe çfarë duhet të bëni nëse diçka nuk është në rregull;
- të keni qasje në trajnime të vazhdueshme për të gjitha aspektet e rolit tuaj;
- të keni mundësi të shprehni mendimin tuaj për çështjet që ju prekin dhe të dëgjoheni;
- të përfshihen dhe të kontribuoni në vendimet brenda Federatës ose aktivitetit;
- t’ju respektojmë dhe trajtojmë siç duhet;
- të ndiheni të mirëpritur, të vlerësuar dhe të mos gjykoheni për shkak të moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, kombësisë, kulturës, etnisë, përkatësisë sociale, fesë ose besimit, opinionit politik dhe nivelit të aftësisë ose paaftësisë tuaj;
- të mbroheni nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi;
- të keni mbështetje për të zgjidhur çdo konflikt.

Unë e kuptoj se nëse nuk e respektoj Kodin, mund të kem bërë shkelje të kushteve përkatëse dhe mund t’iu nënshtrohem masave dhe sanksioneve disiplinore të Federatës në përputhje me politikën e tyre disiplinore.


Shkeljet e përsëritura të Kodit mund të rezultojnë që do të detyrohemi t’ju përjashtojmë përgjithmonë

nga aktiviteti, ngjarja ose Federata, vendim ky që duhet të merret për shkak të mirëqenies së lojtarëve dhe bashkëpunëtorëve tonë.

Nënshkrimi i lojtarit:

Emri dhe mbiemri (me shkronja të shtypit):

Data:



UDHËZUES

PËR
PËRDORIM
HETIM
REAGIM

Udhëzues për përdorimin e sigurt të tualeteve dhe dhomave të veshjes

Shënim: Termi ‘fëmijët’ ose ‘fëmija’ përshkruan çdo person nën moshën 18 vjeç ‘Të rinjtë’ ose ‘i ri’ i referohet çdokujt të moshës 15-24 vjeç (Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 2007). Termi ‘prindër’ u referohet në përgjithësi prindërve dhe kujdestarëve.

Hyrje

Federata e Basketbollit e Kosovës (‘Federata’) dhe organizatat bashkëpunuese e kanë për detyrë të mbrojnë fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm që i kanë nën kujdesin e tyre, si dhe të promovojnë të drejtat e tyre. Dhomat e veshjes (zhveshtoret) mund të jenë vende ku të rinjtë/të rriturit e cënueshëm janë më të pambrojtur ndaj abuzimit të bashkëmoshatarëve, si bullizmi ose sjellja e keqe seksuale dhe mund të jenë burim stresi për fëmijët transgjinorë dhe jobinarë/të rriturit e cënueshëm. Ekzistojnë gjithashtu shumë arsye pse fëmijët dhe të rinjtë mund të kërkojnë privatësi (arsye fetare, sëmundje kronike, imazhi i trupit, gjinia).

Përveç kësaj, shenja abuzimi gjithashtu mund të bëhen të dukshme gjersa fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm ndërrojnë rrobat. Për shembull, ju mund të vini re ndryshime në sjellje, fëmijët nuk ndjehen rehat kur duhet të ndërrohen ose vëreni shenja dhe mavijosje të pazakonta. Në raste të tilla, duhet të ndiqni procedurat e raportimit të paraqitura hollësisht në Politikën tonë për Mbrojtje. Të rriturit duhet të jenë në gjendje t’i mbajnë fëmijët/të rriturit e cënueshëm të sigurt duke iu lejuar atyre privatësi.

Federata dhe organizatat bashkëpunuese duhet të kenë masa për t’u siguruar që fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm të ndihen rehat dhe të sigurt kur ndërrohen për sport. Vëmendje e veçantë duhet t’iu kushtohet masave mbrojtëse që duhen vendosur për të mbrojtur fëmijët/të rriturit e cënueshëm kur shkojnë në palestra të tjera. Gjatë stërvitjeve/ ushtrimeve dhe ngjarjeve sportive duhet të bëhet vlerësimi i rrezikut të zhveshtoret dhe tualetet dhe të merren parasysh elementet e poshtëshënuara:

Lloji i palestrës

Çështja kryesore që duhet të merret parasysh në vendosjen e praktikës së sigurt për dhomat e

veshjes dhe tualetet është nëse ambientet do të përdoren ekskluzivisht nga lojtarët që janë fëmijë dhe të rritur të cënueshëm. Dhomat e veshjes dhe tualetet të cilat do të përdoren vetëm për fëmijët/të rriturit e cënueshëm, nëse është e mundur, zvogëlojnë rrezikun e pasigurisë të fëmijët/të rriturit e cënueshëm se sa kur ato përzihen me të rriturit. Megjithatë, shumë dhoma të veshjes përdoren edhe nga të rriturit (ekipet, lojtarët ose anëtarët e publikut). Të gjitha palestrat duhet të kenë politika dhe procedura të mbrojtjes për raportimin e çdo shqetësimi, dhe stafi përkatës duhet të familjarizohen me këto (aty ku janë në zbatim).

Dhomat e veshjes dhe tualetet

Dhomat e veshjes për të dy gjinitë janë më pak të përshtatshme kur fëmijët rriten. Jini të ndjeshëm ndaj atyre që piqen fizikisht në një moshë shumë më të hershme ose më të vonshme se moshatarët e tyre. Fëmijët zakonisht e fillojnë pubertetin në çdo moment midis moshës 8 dhe 14 vjeç. Stafi përkatës duhet t’i trajtojnë të gjithë në mënyrë të drejtë dhe të tregojë respekt për privatësinë dhe dinjitetin e tyre.

Stafi përkatës duhet të marrë parasysh se si të mbështesin të rinjtë transgjinorë dhe jobinarë/të rriturit e cënueshëm për të përdorur dhomat e veshjes në të cilat ndihen rehat.

Rreziqet që lidhen me kontaktin e tejkaluar ndërmjet të rriturve dhe fëmijëve/të rriturve të cënueshëm mund të zvogëlohen nëse ata pajtohen për një orar të qartë për përdorimin e dhomave të veshjes.

Stafi përkatës duhet të bëjë rregullime adekuate dhe të ndjeshme për pjesën e dhomave të veshjes dhe tualeteve që marrin parasysh nevojat e të gjithë fëmijëve dhe të rriturve të cënueshëm. Kjo duhet të përfshijë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, transgjinorët, jobinarët ose që vënë në dyshim identitetin e tyre gjinor, dhe ata me fe, besime dhe prejardhje kulturore të ndryshme.

Mbikëqyrja

Stafi përkatës duhet të vendosë se cila është

mbikëqyrja e duhur bazuar në moshën dhe nevojat e zhvillimit të fëmijëve dhe të rriturve të cënueshëm që ndryshojnë. Duhet të ndiqen procese më të sigurtat rekrutimi për të siguruar që stafi dhe vullnetarët që ofrojnë mbikëqyrje janë të përshtatshëm për ta bërë këtë.

Kur prindërit/kujdestarët janë në cilësinë e mbikëqyrësit zyrtar, sipas kërkesës ose në bazë të marrëveshjes me stafin përkatës, atëherë duhet të ndiqen praktikatat e sigurtat të rekrutimit sipas politikës sonë të mbrojtjes së fëmijëve dhe procedurave të rekrutimit dhe përzgjedhjes së sigurt.

Nuk është e nevojshme për të rriturit që të qëndrojnë në dhomat e veshjes për t’u siguruar se të gjithë po sillen mirë. Është më se e mjaftueshme nëse të rriturit qëndrojnë diku afër, ndërsa fëmijët/ të rriturit e cënueshëm janë të vetëdijshëm për këtë. Fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm duhet të dinë se të rriturit janë në dijeni se çka po ndodh në dhoma të veshjes ose tualetet dhe, nëse është e nevojshme, ata do të futen brenda për të reaguar në rast të ndonjë situatë shqetësuese ose bullizmi të mundshëm.

Stafi përkatës duhet gjithashtu të merr parasysh parimet e poshtëshënuara të praktikave më të mira:

- Të mbahet pak e hapur dera e dhomave të veshjes që askush të mos shohë brenda, por të rriturit mbikëqyrës të mund të dëgjojnë jashtë nëse ka ndonjë situatë shqetësuese
- Rekomandohet që të ketë më shumë se një të rritur mbikëqyrës për të siguruar mbulesë të çdo cepi në rast të një aksidenti ose incidenti ose nëse një mbikëqyrës duhet të largohet nga aty
- Nëse një i rritur duhet të hyjë në dhomë, ai duhet të paralajmërojë paraprakisht fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm dhe t’u japë atyre mundësinë që të mbulohen nëse duan
- Fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm mund të bëjnë dush vetëm dhe/ose me kostume të larges nëse dëshirojnë
- Kur është e mundur, të rriturit që po mbikëqyrin fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm që janë duke u ndërruar duhet të jenë të së njëjtës gjini me ta
- Të rriturit nuk duhet të qëndrojnë kurrë në dhomë të veshjes duke parë fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm dhe nuk duhet të hyjnë e

dalim vazhdimisht pa arsye të mirë.

- Të rriturit (përveç prindërve dhe kujdestarëve) nuk duhet të ndërrohen apo të bëjnë dush në të njëjtën hapësirë me fëmijët apo të rriturit e cënueshëm
- Fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm duhet të kenë njohuri se me kë të flasin nëse kanë shqetësime për sjelljen e të rriturve ose të rinjve të tjerë. Nëse raportohet ndonjë incident ose shqetësim (i mundshëm), ai duhet të merret seriozisht dhe t’i referohet udhëheqësit të caktuar të Federatës për çështje të mbrojtjes sipas politikës sonë për mbrojtje.

Udhëzues për hetimin e incidenteve & shqetësimeve të mbrojtjes

Hyrje

Shqetësimet e mbrojtjes mund të vijnë drejtpërdrejt nga një fëmijë/person i ri që i tregon një bashkëpunëtori (i njohur si ‘hetues’), nga një bashkëpunëtor që dëshmoi, vërejti ose dëgjoi diçka, ose informacioni mund të ndahet me bashkëpunëtorin nga një person tjetër (si prindi) ose një agjenci të jashtme.

Të gjitha raportimet, incidentet ose shqetësimet e dëmtimit, madje edhe shqetësimet e dyshuara dhe praktikat e dobëta duhet të merren seriozisht dhe duhet të regjistrohen dhe raportohen tek autoritetet përkatëse nëse ato ndodhin brenda një konteksti basketbolli ose jashtë sportit në përputhje me Politikën Mbrojtëse. Nevojat e personit të afektuar duhet të kenë prioritet.

Të gjitha hetimet do të jenë të hollësishme, të ndjeshme dhe do të ndjekin parimet e praktikës së informuar për traumat për të zvogëluar rrezikun e shkaktit të dëmit. Të gjitha hetimet do të fillojnë duke i besuar personit të afektuar.

Varësisht nga natyra e rastit të referuar, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi koordinohet me policinë dhe/ose shërbimet sociale për të mbledhur informata, për të hetuar dhe vlerësuar raportin(et), si dhe/ose për të kryer hetime të ndara.

Mosrespektimi i ndonjë kërkesë të lëshuar nga udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi mund të rezultojë në marrjen e masave kundër personit të cekur sipas rregulloreve të brendshme të Federatës.

Personat përgjegjës për hetim

Udhëheqësi i caktuar i Federatës për çështje të mbrojtjes është përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve të mbrojtjes për raportet, incidentet ose shqetësimet (e dyshuara) të dëmtimit ose praktikës së dobët bazuar në rastin(et) e pranuar/a. Megjithatë, nëse ata kanë menaxhuar drejtpërdrejt ndonjë nga bashkëpunëtorët e përfshirë në rast, atëherë duhet të caktohet dikush që ka përvojën e duhur dhe pavarësi të përshtatshme për të udhëhequr hetimin.

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/

hetuesi duhet të ketë nivelin e përvojës dhe njohurive profesionale për të qenë në gjendje të analizojë në mënyrë kritike situatën. Ata duhet të jenë në gjendje të mbledhin, grumbullojnë dhe analizojnë informacione nga disa burime.

Ekzaminimi fillestar

Pas pranimit të një referimi, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi do të kontrollojë lëndën për të konfirmuar se ka të bëjë me një raport të mbrojtjes, incident ose shqetësim (të dyshuar) për dëmtim ose praktikë të dobët dhe/ose shkelje të kësaj politike të mbrojtjes ose politikat dhe procedurat shoqëruese përkatëse. Nëse ndodh, udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi duhet të hetojë dhe të vendosë për veprimet e menjëhershme, ku mbi të gjitha i jep përparësi mirëqenies së personit të afektuar.

Përcaktimi i kushteve të referimit

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi duhet të hartojë kushtet e referimit për hetimin. Në këto kushte përfshihen kufijtë e shtrirjes së hetimit. Kushtet e referimit duhet të përfshijnë:

- Qëllimet dhe objektivat e hetimit,

- Fushëveprimin e hetimit,

- Metodologjinë që do të përdoret,

- Afatin kohor të hetimit,

- Kufizimet e mundshme të identifikuara në planifikimin e hetimit,

- Konfidencialitetin dhe kufizimet në shpërndarjen e raportit.

Informimi i personave të përfshirë

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi do të informojë palën e përfshirë për natyrën e shqetësimit dhe hetimin në çastin që ata e konsiderojnë të përshtatshme. Kjo mund të mos

ndodhë menjëherë, por do të përcaktohet në bazë të rrezikut të dëmtimit të individëve, rrezikut të paragjykitimit të hetimit, nëse duhet të ndërmerret ndonjë masë e përkohshme dhe në bazë të pikëpamjeve të udhëheqësit kryesor për çështje të mbrojtjes/hetuesit.

Është thelbësore që të akuzuarit/palës së përfshirë t’i jepet mundësi e drejtë për t’iu përgjigjur çdo shqetësimi të mbrojtjes të bërë kundër tij. Para se të intervistohen, atyre duhet t’u jepet një përmbledhje (jo detaje të plota) të shqetësimit(ve) të ngritura kundër tyre.

Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi do të qëndrojë në kontakt të rregullt me të gjithë të përfshirët në një hetim, por ata mund të mos jenë në gjendje të zbulojnë të gjitha informatat në dispozicion për arsye të mbrojtjes së të dhënave ose për të shmangur paragjykimin e rastit.

Planifikimi i hetimit

Hetimi duhet të merr parasysh katër aspekte kryesore: njerëzit, dokumentet, pjesët dhe vendet (shih më poshtë) për t’u siguruar se hetimi është mjaft i detajuar:

- Njerëzit** – me kë duhet të flasin si pjesë e hetimit? Kjo duhet të përfshijë personin e afektuar, prindërit/kujdestarët e tyre (sipas nevojës), çdo dëshmitar (fëmijë apo të rritur), profesionistë të tjerë (sipas nevojës),

- Dokumentet** – çdo dokument (i shkruar ose fotografi, përfshirë edhe dokumentet në internet) në lidhje me rastin. Për shembull, formulari fillestar i raportimit të incidentit, çdo informacion i ofruar nga policia ose shërbimet sociale (ku është në dispozicion), çdo pamje, foto ose shënime,

- Pjesët** – çdo pajisje ose burim që ngrihet në pretendim,

- Vendet** – vendi(at) ku thuhet se ka ndodhur incidenti.

Hetimi

Hetimet duhet të kryhen në afat të përshtatshëm kohor, por pa cenuar cilësinë e hetimit. Çdo hetim

do të jetë i ndryshëm dhe njerëz të ndryshëm mund t’i kryejnë hetimet e tyre paksa ndryshe. Megjithatë, shumica e hetimeve zakonisht përfshijnë hapat e mëposhtëm:

- Mbledhja e deklaratave nga ankuesit fillestarë dhe të gjithë dëshmitarët,

- Mbledhja e deklaratave nga çdo dëshmitar tjetër i identifikuar,

- Zbulimi i përmbledhjes së shqetësimeve për personin e akuzuar/palën e përfshirë,

- Një intervistë me personin e akuzuar/palën e përfshirë,

- Mundësi shtesë për personin e akuzuar/palën e përfshirë për të paraqitur ndonjë provë ose në letër ose elektronike.

Intervistimi i njerëzve

Pasi të keni vendosur se kë do të dëshironi të intervistoni dhe me kë do të filloni, atëherë do t’ju duhet të organizoni datat/orët dhe vendet e takimit me ta. Mendoni nëse mund t’ju duhet të kërkonti mendimin e një eksperti, për shembull, një mjeku ose punëtori social.

Planifikoni intervistat, duke u siguruar që ato të mos ndërpriten. Sigurohuni që ta keni fikur celularin dhe kërkonti të intervistuarit të bëjë të njëjtën gjë. Mundohuni t’i mbani intervistat më pak se një orë. Nëse duhet të jenë më të gjata, planifikoni të bëni disa pushime për çlodhje. Është e rëndësishme që si hetues gjatë gjithë kohës të jeni të sjellshëm, të qetë dhe profesional. Siguroni faculeta dhe ujë dhe përgatituni për të menaxhuar disa situata emocionale.

Secila intervistë duhet të planifikohet dhe përgatitet paraprakisht. Pas një hyrjeje, shpjegoni arsyen dhe qëllimin e intervistës. Mundohuni ta qetësoni të intervistuarin; ata kanë më shumë gjasa të komunikojnë me ju nëse ndihen të relaksuar.

Kërkonti nga i intervistuari t’ju tregojë më shumë për situatën dhe për çdo informacion bazë që mund të jetë i rëndësishëm. Planifikoni disa pyetje veçanërisht kur ka mungesë të informatave, megjithatë, përgatituni që edhe nëse intervista mund të duket se po shkon mirë, ajo mund të shkojë në një drejtim tjetër nga ai i planifikuar, veçanërisht nëse ka zbulime të mëtejshme.

Përpiquuni të përdorni pyetje të hapura në vend të pyetjeve të mbyllura (po/jo) dhe përgatituni për heshtje për t’i lejuar njerëzit të mendojnë. Kërkoni sqarime për t’u siguruar që i keni kuptuar saktë dhe sfidoni aty ku mundeni.

Mos harroni se fëmijët dhe të rinjtë, veçanërisht ata me cenueshmëri shtesë (p.sh., me aftësi të kufizuar), mund të përballen me pengesa shtesë për zbulimin ose diskutimin e incidenteve ose shqetësimeve, kështu që përpiquuni të siguroheni që qasja dhe pyetjet tuaja të jenë në përputhje me këtë dhe të jenë gjithëpërfshirëse.

Mbyllja e intervistës është e rëndësishme pasi nuk dëshironi që procesi i hetimit të shkaktojë ndonjë dëm. Pas intervistës, dokumentoni me kujdes gjithë diskutimin. Mbajeni atë faktike. Nëse mendoni se është e rëndësishme të përfshini mendimin tuaj, atëherë sigurohuni që ai të jetë i dokumentuar qartë si opinion dhe jo si fakt.

Kontrollimi i dokumenteve

Kërkoni çdo dokument nga burimet përkatëse që lidhet me rastin. Kjo mund të marrë pak kohë për t’u qasur në to nëse vijnë nga burime të ndryshme. Merrni parasysh të gjitha burimet e mundshme të informacionit: fotografitë, pamjet, email-at, mesazhet, shënimet, burimet në internet (siç janë mediat sociale) etj., si dhe çdo raport nga policia/ shërbimet sociale ose agjenci të tjera të jashtme (aty ku ka).

Lexoni dhe mbani shënime për çdo pikë me interes ose shqetësim.

Kontrollimi i pajisjeve ose burimeve të tjera

Nëse mundeni, përpiquuni të inspektoni çdo pajisje ose sende të tjera të përmendura që janë të rëndësishme për incidentin ose shqetësimin. Mbani shënime dhe fotografojeni çdo pikë interesi, mangësie ose shqetësimi.

Inspektimi i vendeve

Nëse mundeni, inspektoni vendin(et) ku thuhet se ka ndodhur incidenti ose shqetësimi. Mbani shënime dhe fotografojeni çdo pikë interesi, mangësie ose shqetësimi.

Raporti

Filloni të hartoni raportin tuaj ndërsa punoni në procesin e mësipërm. Filloni duke përcaktuar kushtet e referimit dhe duke përshkruar individët e përmendur në raport përfshirë edhe marrëdhëniet e tyre, në mënyrë që lexuesi të kuptojë se kujt i referoheni. Gjatë gjithë kohës përdorni emrat e plotë dhe shmangni përdorimin e termave të tillë si ‘nëna e fëmijës’ ose ‘babai i fëmijës’.

Përshkruani procesin e hetimit tuaj dhe çfarë keni gjetur në çdo fazë, duke përfshirë provat ku ato janë në dispozicion. Sigurohuni që të jeni të qartë, konciz, të kuptueshëm, faktik dhe objektiv në përdorimin e gjuhës.

Në fund tregoni qartë rezultatin e hetimit. Kjo mund të jetë:

- Incidenti ose shqetësimi nuk mbështetet – çështja do të mbyllet pa asnjë veprim të mëtejshëm,
- Incidenti ose shqetësimi konsiderohet si keqdashës – çështja do të mbyllet, por mendoni nëse do të referoni këdo që bën një ankesë keqdashëse në procedurat disiplinore të Federatës. Mos harroni se ankesat me qëllim të keq janë shumë të rralla; ka shumë më tepër gjasa që personi që bën referimin të ketë keqkuptuar ose të mos ketë të gjithë informacionin e kërkuar, por të jetë mjaft i shqetësuar për mirëqenien e fëmijës për të bërë një referim. Kjo është e pranueshme – tregon se njerëzit po e marrin seriozisht mbrojtjen dhe se procesi i hetimeve po funksionon. Masat disiplinore duhet të merren vetëm në rastet kur referimi është bërë në mënyrë të qartë dhe të paqartë me qëllim keqdashës,
- Incidenti ose shqetësimi mbështetet – Udhëheqësi i caktuar për çështje të mbrojtjes/hetuesi do të njoftojë FIBA-n dhe do t’ia referojë çështjen Panelit Disiplinor të Federatës për të shqyrtuar dhe vendosur një sanksion të duhur.

Ndarja e raportit

Merrni parasysh konfidencialitetin dhe kufizimet në qarkullimin/shpërndarjen e raportit (siç janë identifikuar në kushtet e referimit). Nuk do të jetë gjithmonë e përshtatshme që raporti i plotë t’iu shpërndahet të gjithë të përfshirëve ose prindërve të fëmijës (fëmijëve) të përfshirë sepse raporti mund të përmbajë informacione për fëmijë të tjerë dhe do të shkelte Rregulloret e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave. Ai gjithashtu mund të përmbajë informata për individë ose për Federatën, të cilat që nuk do të ishte e përshtatshme që të bëhen publike.

Një përmbledhje e raportit, me pjesët përkatëse të fshira për arsye konfidencialiteti, duhet t’i dorëzohet ankuesit/personit të prekur dhe personit të akuzuar/personin në fjalë dhe/ose prindërit e tyre. Raporti duhet t’iu dorëzohet gjatë një takimi të organizuar zyrtarisht me ta, ku ata mund të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime, e jo përmes email-it.

Udhëzues për reagim ndaj ekspozimeve

Shënim: termi ‘fëmijët’ ose ‘fëmija’ përshkruan çdo person nën moshën 18 vjeç, megjithëse parimet e mëposhtme duhet të zbatohen për trajtimin e të gjitha ekspozimeve, pavarësisht nga mosha e personit që e bën atë.

Për të siguruar një mjedis të sigurt dhe pozitiv brenda programeve, aktiviteteve dhe ngjarjeve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (‘Federata’), është e rëndësishme të jeni të përgatitur nëse një individ zbulon abuzim. Mund të jetë shumë e vështirë për njerëzit të hapet për atë që i ka ndodhur. Ky dokument përshkruan praktikën më të mira për të reaguar ndaj deklarimeve të abuzimit për të siguruar që personi që raporton të ndihet i dëgjuar. Më poshtë janë rekomandimet për t’ju ndihmuar t’u tregoni individëve se çfarëdo që duan të ndajnë, ju jeni gati të dëgjoni. Gjithashtu përfshihen burime për të ndihmuar fëmijët, të cilët shpesh e kanë shumë të vështirë për të raportuar incidentet e dhunës/abuzimit.

Në përputhje me Politikën e Federatës për Mbrojtje, të gjitha zbulimet, incidentet ose shqetësimet (të dyshuara) të dëmtimit ose praktikave të dobëta duhet të merren seriozisht. Ato duhet të regjistrohen dhe raportohen tek autoritetet përkatëse nëse ato ndodhin në kuadër të aktiviteteve të basketbollit ose jashtë sportit (zakonisht brenda 24 orëve). Nëse raporti juaj fillestar bëhet me gojë te udhëheqësi i Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes, atëherë ju duhet ta ndiqni këtë me një raport me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur (zakonisht brenda 24 orëve).

Nëse një individ është në rrezik të menjëhershëm, telefononi policinë dhe/ose shërbimet sociale/organet përkatëse ligjore

Më poshtë janë rekomandimet se çfarë duhet t’i thuhet një individ që raporton një incident ose shqetësim për dhunë ose abuzim.

1. Dëgjoni me kujdes atë që po thonë

Jini të durueshëm dhe përqendrohuni në atë që ju thonë. Mundohuni të mos shprehni pikëpamjet dhe ndjenjat tuaja. Nëse dukeni të tronditur ose sikur nuk u besoni atyre, kjo mund t’i bëjë ata që të mos flasin dhe të mohojnë atë që kanë thënë.

- Tregoni kujdes, ndihmohuni ata të hapen: Kushtojini vëmendjen tuaj të plotë individit dhe mbajeni gjuhën e trupit tuaj të hapur dhe inkurajuese. Jini të dhembshur, jini të kuptueshëm dhe sigurojini se ndjenjat e tyre janë të rëndësishme. Ndihmohuni shumë edhe frazat si si “keni qenë shumë i guximshëm sot”.

- Mos u ngutni, flisni ngadalë: respektoni pauzat dhe mos e ndërprisni atë – lërini që të flasin vetë me ritmin e tyre. Mundohuni t’i njihni ata dhe t’i përgjigjeni gjuhës së trupit të tyre.

- Tregoni se i kuptoni; reflektoni përsëri: bëjeni të qartë se jeni të interesuar për atë që ata ju thonë. Reflektoni atë që ata kanë thënë për të parë sa i keni kuptuar – dhe shtyni ata të flasin me fjalë të veta – është përvoja e tyre.

2. Nxitni të flasin

Nëse ngurrojnë të flasin, disa nga burimet e më poshtme mund të ndihmojnë. Provoni të përdorni këshilla të thjeshta që mund t’i gjeni në pjesën e fundit të këtij dokumenti për t’i ndihmuar ata të tregojnë se çfarë po ndodh dhe si ndihen.

3. Bëjini të ditur se kanë bërë gjënë e duhur që ju kanë treguar

Sigurimi mund të ketë ndikim të madh. Nëse ata e kanë fshehur dhunën dhe abuzimin, mund të ketë ndikim të madh duke ditur se ata kanë rrëfyer se çka iu ka ndodhur.

4. Tregojuni se nuk është faji i tyre

Dhuna dhe abuzimi nuk ndodhin kurrë për fajin e individëve. Është e rëndësishme që ata ta dëgjojnë

dhe ta dinë, kështu që duhet t’ua thoni atyre.

5. Merrni seriozisht dhe thuajeni këtë

Ata mund ta kenë mbajtur të fshehtë dhunën dhe abuzimin sepse kishin frikë se nuk do t’iu besonin. Sigurohuni që ata e dinë se mund t’ju besojnë dhe ju do t’i dëgjoni dhe mbështesni.

6. Mos u përballni me abuzuesin e supozuar

Përballja me abuzuesin e supozuar mund ta përkeqësojë situatën. Gjithmonë raportoni përmes procedurave të përshkruara në Politikën e Federatës për Mbrojtje dhe kurrë mos u përballni ose mos u afroni me personat e përfshirë.

7. Shpjegoni se çka do të bëni më pas

Shpjegoni se do të flisni me dikë që do të jetë në gjendje të ndihmojë (ky do të jetë udhëheqësi i Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes, por mund të jetë edhe agjenci të jashtme) dhe tregoni se kush do të jetë ky individ. Shpjegoni se do ta mbani informacionin sa më konfidencial që të jetë e mundur, në mënyrë që vetëm njerëzve që duhet të dinë do t’u thuhet, por mos premtoni diçka që nuk mund ta mbani ose të thoni se do të mbani gjithçka anonime pasi kjo nuk është e mundur.

8. Raportoni sa më shpejt atë që ju ka thënë individ

Menjëherë sapo dikush t’ju njoftojë për ndonjë rast të abuzimit, raportoni atë te autoritetet përkatëse në mënyrë që detajet të jenë të freskëta në mendjen tuaj dhe të ndërmerren veprime të shpejta (shih Politikën e Federatës për Mbrojtje për procesin e raportimit). Mund të jetë e dobishme të mbani shënime menjëherë pasi të keni folur me individin. Mundohuni t’i mbani këto shënime sa më të sakta

dhe faktike që të jetë e mundur.

Sigurohuni që të përfshini sa vijon:

- të dhënat e individit të afektuar (emrin, moshën, adresën),
- çfarë tha individit ose çfarë ju shqetësoi (nëse individit bëri një deklaratë verbale, shkruani fjalët e tij/saj të sakta),
- çdo informacion që individit ju ka dhënë në lidhje me autorin/personin e supozuar të përfshirë.

Këshilla për fëmijët që (janë duke menduar) të raportojnë rastet e dhunës ose abuzimit

1. Si të filloni bisedën

Ndonjëherë është e vështirë të dini si të bisedoni për diçka të ndjeshme ose edhe shqetësoheni se si do të reagojë dikush. Provoni të filloni bisedën si në vijim:

- “Dua të të them diçka, por nuk e di se si”
- “E kam shumë të vështirë ta them kështu, por kam diçka të rëndësishme për t’ju thënë”,
- “Kam nevojë të këshillohem për diçka për të cilën jam i stresuar”.

Provoni të nisni bisedën duke folur për diçka tjetër që e përmend këtë problem. Mund të jetë çdo gjë, si Facebook, TV, ose një libër, apo edhe diçka në shkollë. Për shembull, “fillimisht i tregova nënës se si gjatë gjithë kohës jam i mërzitur dhe e pyeta atë nëse e kishte parë një shfaqje në TV për depresionin”.

Mund të provoni gjithashtu duke u thënë se po kërkonit një mik. Ndonjëherë është më e lehtë të flasësh kur pretendon se nuk po flet për veten. Nëse personi me të cilin flisni është mbështetës, mund t’i thoni se po flisni për atë.

Nëse ende nuk jeni i sigurt si të filloni bisedën, të

shkruani një letër ose të lini një shënim mund të jetë mënyrë e shkëlqyeshme për të filluar bisedën me dikë që i besoni, sidomos nëse e keni të vështirë të flisni sy me sy.

2. Pyetni nëse mund ta mbajnë sa më konfidenciale atë që thoni

Nëse po mendoni të dërgoni letër ose mesazh, mund të ndihmojë:

- vendosni se kujt do t’ia jepni dhe kur,
- mbani mend se nuk keni nevojë të thoni gjithçka nëse nuk dëshironi,
- mendoni nëse letra duhet të shpërndahet, veçanërisht nëse dikush shqetësohet për sigurinë tuaj,
- sigurohuni që e keni ruajtur atë në një dosje të përbashkët,
- planifikoni atë që dëshironi të bëni më pas.

Nëse shqetësoheni për konfidencialitetin dhe çka mund të mbahet private, pyeteni dikë për këtë përpara se t’i tregoni diçka. Shumica e profesionistëve e kanë për obligim të ndajnë me ju rregullat e tyre.

Nëse janë të shqetësuar për sigurinë tuaj, disa të rritur duhet t’i tregojnë diku tjetër. Kjo duhet të ndodh që ata mund t’ju ndihmojnë dhe t’ju mbrojnë.

3. Mënyrat për t’u ndjerë të sigurt

Përgatitni

Planifikoni atë që dëshironi të thoni dhe përpikuni të mendoni për disa shembuj të asaj që ka ndodhur. S’keni nevojë t’ju tregoni gjithçka menjëherë - ndani atë informatë me të cilën ndiheni komod dhe pritni të shihni çka kanë për të thënë.

Ushtroni

Ushtroni para pasqyrës atë që doni ta thoni me zë të lartë ose mund të ushtroni me një mik.

Gjeni kohën e duhur për të folur


Mundohuni të gjeni një kohë kur personi me të cilin dëshironi të bisedoni nuk është shumë i zënë ose nuk do të nxitojë. Gjithashtu mund t’u kërkonit atyre të gjejnë një kohë të qetë për të folur, kështu që do të keni vëmendjen e tyre të plotë.

4. Dijeni kujt mund t’i drejtoheni për të folur

Mos harroni se ka shumë vende ku mund të shkoni për të folur për shqetësimet tuaja dhe për të marrë mbështetje. Mund të flisni me një prind ose dikë në klubin tuaj, ose të kontaktoni udhëheqësin e Federatës të caktuar për çështje të mbrojtjes XX VENDOSNI TË DHËNAT E PERSONIT XX.

Gjithashtu mund të telefononi në numrin e telefonit të linjës së ndihmës për fëmijë 116 111 nga kudo në Evropë.

POLITIKA E SIGURISË SË INTERNETIT DHE E MEDIAVE SOCIALE



Shënim:

Kjo politikë vlen për të gjithë bashkëpunëtorët e Federatës së Basketbollit të Kosovës ('Federata' dhe 'organizata')

termi 'fëmijët' ose 'fëmija' përshkruan çdo person nën moshën 18 vjeç.

termi "prind" përshkruan këdo që ka kujdestari ose kujdeset dhe ka përgjegjësi prindërore për fëmijën

termi 'bashkëpunëtor' përshkruan anëtarët e stafit, trajnerët, fëmijët, lojtarët mbi moshën 18 vjeç, prindërit dhe të tjerët që bashkëpunojnë me Federatën sipas përkufizimit në Politikën e Mbrojtjes e Federatës.

Deklarata jonë e sigurisë për internet

Kjo politikë parashikon kërkesa për mënyrën se si Federata përdorë internetin dhe mediat sociale, si dhe procedurat për ta bërë këtë. Dokumenti gjithashtu përshkruan se si ne presim që të sillen në internet bashkëpunëtorët që punojnë/bëjnë punë vullnetare për ne, dhe fëmijët dhe të rinjtë që janë anëtarë të organizatës sonë.

Si Federatë, ne angazhohemi të zbatojmë këtë politikë dhe të adresojmë çdo shqetësim shpejt dhe brenda këtyre udhëzimeve.

Synimet

Synimet e politikës sonë të internetit janë:

- për të mbrojtur të gjithë individët të përfshirë në organizatën tonë dhe që përdorin teknologjinë (të tilla si telefonat mobilë, konzolat e lojërave dhe internetin),
- t'u ofrojë bashkëpunëtorëve informacion mbi politikën dhe procedurat në lidhje me sigurinë e internetit dhe t'i informojë ata se si të përgjigjen ndaj incidenteve dhe shqetësimeve (të mundshme),
- për të siguruar që organizata jonë të

funksionojë në përputhje me vlerat tona dhe brenda ligjit në lidhje me mënyrën se si ne sillemi në internet.

Të kuptuarit e botës së internetit

Si pjesë e përdorimit të internetit dhe mediave sociale, organizata jonë do:

- të vlerësojë dhe menaxhojë aspektet e sigurisë – duke përfshirë atë që është sjellje e pranueshme dhe e papranueshme për të gjithë bashkëpunëtorët, lojtarët, trajnerët, etj. kur përdorin faqet e internetit, mediat sociale, si Facebook, TikTok, Instagram, X ose Snapchat, aplikacionet dhe platformat e video-konferencave si Teams dhe Zoom.
- të jetë e vetëdijshme se si anëtarët e organizatës sonë dhe lojtarët me të cilët punojnë/janë vullnetarë përdorin mediat sociale brenda dhe jashtë mjedisit tonë.
- të sigurojë që t'i përmbahemi legjislacionit përkatës kur përdorim media sociale ose platforma të video-konferencave.
- të ofrojë trajnime për bashkëpunëtorin përgjegjës për menaxhimin e pranisë së organizatës sonë në internet.
- të rishikojë rregullisht politikën ekzistuese të mbrojtjes dhe procedurat përkatëse për të siguruar që çështjet e mbrojtjes në internet janë integruar plotësisht, duke përfshirë:
 - të sigurojë se shqetësimet (e mundshme) të dhunës, abuzimit, bullizmit, etj. ose raportimit që ndodhin në internet janë të shkruara në procedurat tona të raportimit,
 - se bullizmi në internet ("bullizmi kibernetik") është përfshirë në politikën tonë kundër bullizmit.

Menaxhimi i pranisë në internet

Prania jonë në internet përmes faqeve tona të internetit ose platformave të mediave sociale do t'i përmbahet udhëzimeve të poshtëshënuara:

- të gjitha llogaritë e mediave sociale do të

jenë të mbrojtura me fjalëkalim, dhe të paktën 2 anëtarë të Federatës do të kenë qasje dhe fjalëkalim për çdo llogari.

- llogaria do të monitorohet nga të paktën dy anëtarë të caktuar nga Federata për të siguruar transparencë.

- bashkëpunëtorët e caktuar që menaxhojnë praninë tonë në internet do të kërkojnë këshilla nga udhëheqësi i Federatës i caktuar për çështje të mbrojtjes për të ofruar këshillat për kërkesat e mbrojtjes.

- bashkëpunëtorët e caktuar do të heqin postimet e papërshtatshme të bashkëpunëtorëve, duke shpjeguar pse, dhe duke informuar këdo që mund të afektohet (prindërit e çdo fëmije/ të rrituri të cënueshëm të përfshirë).

- ne do të refuzojmë kërkesat e fëmijëve nën moshën 13 vjeç për t’u bërë pjesë e llogarive të mediave sociale të Federatës (nën 16 vjeç për WhatsApp).

- ne do të sigurohemi që të gjithë bashkëpunëtorët e dinë se kush i menaxhon llogaritë tona të mediave sociale dhe kë të kontaktojnë nëse kanë ndonjë shqetësim për diçka që ka ndodhur në internet.

- veçoritë e llogarisë, faqes dhe ngjarjeve tona do të vendosen në “private” në mënyrë që vetëm anëtarët e pranuar/ftuar të mund të shohin përmbajtjen e tyre.

- të gjitha detajet identifikuese si adresa e një bashkëpunëtori, emri i shkollës/shtëpisë, adresa ose numri i telefonit nuk duhet të postohen në platformat e mediave sociale ose të video-konferencave.

- çdo postim apo korrespondencë do të jetë në përputhje me qëllimet dhe tonin tonë si Federatë.

- prindërve do t’u kërkohet të japin miratimin e tyre me shkrim që ne të komunikojmë me fëmijët e tyre/të rriturit e cënueshëm nëpërmjet rrjeteve sociale, nëpërmjet platformave të video-konferencave ose përmes çdo mjeti tjetër komunikimi.

- leja me shkrim për fotografi ose video duhet të jepet para se të postohen në rrjetet sociale.

- Seancat e video-konferencave do të jenë të mbrojtura me fjalëkalim për të

ruajtur privatësinë dhe për të parandaluar ekspozimin ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme ose të dëmshme nga palët e treta.

Sjellja në internet

Kodet e Sjelljes së Federatës përcaktojnë standardet e pritura të sjelljes dhe përfshijnë sjelljen në mediat sociale. Para se të postoni në rrjetet sociale:

- Mos u ngutni dhe mendoni për atë që po thoni dhe ndikimin që mund të ketë.

- Jini të kujdesshëm, të respektueshëm dhe pozitiv. Ju jeni personalisht përgjegjës për atë që postoni. Nëse keni dyshime, mos e postoni.

- Mendoni për imazhin tuaj – ‘çfarë dua që njerëzit të mendojnë për mua ose për Federatën time?’

- Merrni parasysh se me kë po bashkëbisedoni – sigurisht që do të vini në kontakt në internet edhe me fëmijë dhe të rriturit e cënueshëm. Njihuni me rregullat e mbrojtjes në lidhje me bashkëbisedimin me fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm.

- Respektoni konfidencialitetin brenda ekipit – p.sh., taktikat, informacionet e ekipit, njoftimet, këshillat e trajnerit, seancat stërvitore.

- Mos harroni se shumë audienca të ndryshme do të shohin postimet tuaja, duke përfshirë anëtarët e Federatës, bashkëpunëtorët e mundshëm, fëmijët, të afërmit e bashkëpunëtorëve, miqtë.

- Jini të zgjuar për të mbrojtur veten, privatësinë dhe informatat tuaja personale dhe/ose konfidenciale. Ajo që publikoni është gjerësisht e qasshme dhe do të jetë e disponueshme për një kohë të gjatë, prandaj keni shumë kujdes për përmbajtjen dhe cilësimet tuaja të privatësisë.

- Mos postoni përmbajtje që diskriminon individët ose grupet për shkak të moshës, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, kombësisë, kulturës, etnisë, përkatësisë sociale, fesë ose besimit, opinionit politik dhe nivelit të aftësisë ose paaftësisë.

- Mos shkruani asgjë në platformat e mediave sociale që nuk do të ndiheshit rehat ta shihni në një gazetë ose ta dëgjoni në TV. Gjithçka që shkruani trajtohet si një citat i drejtpërdrejtë - p.sh., “Mos posto në internet atë që nuk do t’i thoshe nënës/gjyshit” ose “Mendo para se të postosh në internet” ose “A do t’ia thuash këtë dikujt në fytyrë?”

- Mos flisni negativisht për anëtarët e Federatës, garuesit, zyrtarët ose organet drejtuese. Asnjëherë mos përdorni sharje, fyerje personale ose fjalë të turpshme. Jini profesionistë dhe respektues.

- Rrini me mendje të shëndoshë kur bëni një postim. Kurrë mos postoni kur jeni të zemëruar, të mërzitur ose kur gjykimi juaj nuk është i drejtë. Jini shumë të kujdesshëm se çfarë thoni, bëni dhe postoni sepse sapo të vendoset në platformë të mediave sociale, postimi shumë shpejt mund të bëhet viral.

- Mos u përfshini në mosmarrëveshje në internet dhe mos lejoni familjen ose miqtë të debatojnë në emrin tuaj.

Çfarë presim nga bashkëpunëtorët tanë

- bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë politikë dhe të sillen në përputhje me të.

- bashkëpunëtorët duhet të kërkojnë këshillën e udhëheqësit të caktuar të Federatës për çështje të mbrojtjes nëse kanë ndonjë shqetësim në lidhje me përdorimin e internetit ose mediave sociale.

- bashkëpunëtorët duhet të komunikojnë çdo mesazh që dëshirojnë t’u dërgojnë fëmijëve/ të rriturve të cënueshëm dhe ta përcjellin atë te bashkëpunëtori i caktuar përgjegjës për praninë e organizatës në internet.

- bashkëpunëtorët nuk duhet të komunikojnë me fëmijë ose të rriturit e cënueshëm nëpërmjet llogarive personale.

- bashkëpunëtorët nuk duhet të ‘miqësohen’ ose ‘ndjekin’ fëmijët ose të rriturit e cënueshëm nga llogaritë personale në mediat sociale dhe duhet të mbajnë të njëjtët kufij

profesionalë në internet me të gjithë siç do të bënin personalisht kur përdorin llogaritë e Federatës.

- bashkëpunëtorët duhet të sigurohen që çdo përmbajtje e postuar në llogaritë personale publike është e saktë dhe e përshtatshme pasi bashkëpunëtorët e tjerë mund t’i ‘ndjekin’ ata në mediat sociale.

- në vend që të komunikojnë me prindërit përmes llogarive personale të mediave sociale, bashkëpunëtorët duhet të zgjedhin një mjet më formal komunikimi, si ballë për ballë, me email ose me shkrim, ose të përdorin llogarinë ose faqen e internetit të Federatës.

- email-et ose mesazhet duhet të ruajnë tonin e Federatës dhe të jenë të shkruara në mënyrë profesionale – p.sh., në të njëjtën mënyrë që do të komunikoni në një mjedis profesional, duke shmangur puthjet (xxx), ose duke përdorur zhargon ose gjuhë të papërshtatshme.

- bashkëpunëtorët nuk duhet të fshijnë asnjë mesazh ose komunikim të dërguar në ose nga llogaritë e Federatës.

- bashkëpunëtorët duhet të ndjekin të gjitha trajnimet e ofruara për sigurinë në internet dhe të fitojnë njohuri bazë për platformat dhe mënyrën e raportimit ose heqjes së përmbajtjes së papërshtatshme në internet.

- çdo incident ose shqetësim (i mundshëm) i raportuar përmes mediave sociale duhet të trajtohet në të njëjtën mënyrë si një zbulim ballë për ballë dhe në përputhje me procedurat e raportimit të Politikave Mbrojtëse të Federatave.

- të paktën njëri prind duhet të jetë në shtëpi dhe i pranishëm gjatë shpërndarjes së çdo aktiviteti për fëmijët ose të rriturit e cënueshëm dhe kur përdoret platforma e video-konferencave.

- çdo shpërndarje e aktiviteteve për fëmijët ose të rriturit e cënueshëm nëpërmjet platformave video-konferencave do të mbështetet nga një anëtar shtesë i bashkëpunëtorit (edhe nëse ata nuk po kryejnë në mënyrë aktive) për të siguruar transparencë.

- anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Federatës

asnjëherë nuk duhet të përfshihen në ‘sexting’ (mesazhe me përmbajtje seksuale) ose të dërgojnë gjëra që janë të turpshme.

Çka presim nga fëmijët dhe të rinjtë

- fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë Politikë të Sigurisë në internet dhe të pajtohen me kushtet e saj.
- ne presim që sjellja e fëmijëve dhe të rriturit e cënueshëm në internet të jetë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në këtë Politikë dhe Kodin përkatës të Sjelljes së Federatës.

Çka presim nga prindërit

- prindërit duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë Politikë të Sigurisë në internet dhe të pajtohen me kushtet e saj.
- prindërit duhet të mbrojnë privatësinë e të gjithëve në internet dhe të mendojnë me kujdes se çfarë përmbajtjesh ndajnë në lidhje me sportin tonë në internet, ku dhe me kë po e ndajnë atë.
- ne presim që sjellja e prindërve në internet të jetë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në këtë Politikë dhe Kodin përkatës të Sjelljes së Federatës.

Përdorimi i telefonave mobil ose teknologjive të tjera dixhitale për të komunikuar

Kur përdorni telefona mobil (ose pajisje të tjera) për të komunikuar me zë, video ose tekst (duke përfshirë mesazhet me tekst, email dhe mesazhe të menjëhershme si WhatsApp ose Facebook Messenger), ne do të marrim masat paraprake të mëposhtme për të garantuar sigurinë e të gjithëve:

- bashkëpunëtorët do të shmangin marrjen e

numrave celularë personalë të fëmijëve dhe të rriturve të cënueshëm dhe në vend të kësaj do të kërkojnë kontakt nëpërmjet një prindi.

- do të kërkojmë lejen e prindërve në çdo rast që kemi nevojë për të kontaktuar drejtpërdrejt fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm; qëllimi për çdo kontakt do të identifikohet qartë dhe do të ketë marrëveshje paraprake.

- do të organizohet një metodë e përgjegjshmërisë, si p.sh. kopjet e teksteve, mesazheve ose email-eve që do t'i dërgohen edhe një bashkëpunëtori tjetër ose prindërve.

- përdoruesit e telefonave të mençur duhet të respektojnë jetën private të të tjerëve dhe të mos bëjnë apo shpërndajnë fotografi të njerëzve të tjerë që mund të cenojë privatësinë e tyre.

- sipas nevojës, bashkëpunëtorët duhet të kenë një telefon të veçantë nga ai personal për çdo kontakt me prindërit ose fëmijët dhe të rriturit e cënueshëm.

- tekstet, email-et ose mesazhet do të përdoren për komunikimin e informacionit – si për shembull për t'u kujtuar lojtarëve/prindërve për ngjarjet e ardhshme, cilat pajisje duhet të sjellin ose orarin e stërvitjeve – dhe jo për t'u përfshirë në bisedë.

- nëse një individ e keqinterpreton një komunikim të tillë dhe përpiket të përfshijë një bashkëpunëtor në bisedë, bashkëpunëtori do të ndërmarrë hapat e mëposhtëm: të përfundojë bisedën ose të mos përgjigjet:

- sugjeroni ta diskutoni më tej këtë temë në stërvitjen ose ngjarjen tjetër.

- informoni udhëheqësin e caktuar nga Federata për çështje të mbrojtjes në interes të transparencës.

- nëse jeni të shqetësuar për fëmijën ose të riun, jepni detajet e kontaktit të udhëheqësi i caktuar nga Federata për çështje të mbrojtjes dhe/ose agjencitë e jashtme përkatëse dhe raportoni çdo shqetësim duke përdorur procedurat e raportimit të Federatës (shih Politikën e Mbrojtëse).

Përdorimi i telefonave mobil gjatë aktiviteteve sportive

Ne nuk e preferojmë përdorimin e celularëve gjatë aktiviteteve sportive sepse duam që të gjithë të kënaqen dhe të marrin pjesë aktive në atë aktivitet. Si pjesë e kësaj politike ne do të:

- ndërgjegjësojmë lojtarët/prindërit se si dhe kë duhet të kontaktojnë nëse ka diçka emergjente ose ndonjë ndryshim nga marrëveshjet paraprake me Federatën.

- informoni prindërit për momentet e përshtatshme që ata mund të kontaktojnë fëmijët/të rriturit e cënueshëm që janë nëpër kampe ose udhëtime të largëta dhe këshilloni ata që të përpiqen të kontaktojnë brenda orareve të përcaktuara.

- këshilloni prindërit se mund të mos jetë e mundur të kontaktohen lojtarët gjatë aktiviteteve dhe siguroni një kontakt brenda Federatës, i cili do të jetë i qasshëm në rast të ndonjë emergjence.

- shpjegoni të gjithëve se si përdorimi i telefonave mobil gjatë aktiviteteve ka ndikim në ndërgjegjësimin e tyre të sigurt për mjedisin e tyre, si dhe në nivelin e pjesëmarrjes dhe arritjeve të tyre.

Shkelja e politikës

Bashkëpunëtorët që shkelin këtë politikë (dhe politika e lidhura), paraprakisht do të përballen me një paralajmërim. Shkeljet e vazhdueshme do të trajtohen përmes politikës disiplinore të Federatës.

Çdo shkelje e një natyre mbrojtëse do të adresohet përmes Politikës së Mbrojtjes së Federatës dhe procedurave të lidhura me të dhe, aty ku është e përshtatshme, do të raportohet te udhëheqësi i Federatës për çështje të mbrojtjes.

Gjersa Federata do të përpiket të moderojë postimet në mediat sociale, nëse keni ndonjë shqetësim ose dëshironi të bëni një ankesë, ju lutemi kontaktoni udhëheqësin e caktuar nga Federata për çështje të mbrojtjes.

Politikat dhe procedurat e ndërlydhura

- Politika për mbrojtje

- Kodet e sjelljes

- Politika disiplinore

Kontaktet e rëndësishme

Kontakte për këtë politikë dhe sigurinë në internet:

Udhëheqësi kryesor i faqes sonë të internetit dhe mediave sociale

Emri:
Numri i telefonit:
Email adresa:

Udhëheqësi i caktuar për çështje të sigurisë

Emri:
Numri i telefonit:
Email adresa:

Nënshkrimi i bashkëpunëtorit, prindit ose lojtarit:

Emri me shkronja të shtypit:

Data:

Deklarata e përdorimit të pranueshëme internetit dhe mediave sociale

Federata e kupton rëndësinë e komunikimit në internet. Megjithatë, ne e pranojmë se duhet të vendosen masa mbrojtëse përkatëse për të siguruar që të gjithë janë të sigurt kur përdorin internetin ose gjatë përdorimit të mediave sociale.

Kërkojmë nga të gjithë të kalojnë disa minuta për ta lexuar dhe diskutuar këtë deklaratë (prindërit duhet të diskutojnë për këtë deklaratë me fëmijën e tyre) dhe më pas të nënshkruajnë dhe ta kthejnë këtë formular në [vendosni emrin & të dhënat kontaktuese duke përfshirë email adresën].


Marrëveshja

- Unë jam përgjegjës për sjelljen time kur përdor telefonin tim në klub, përfshirë edhe përmbajtjen në të cilën qasem dhe mënyrën se si sillem.
- Nuk do të krijoj, shfletoj ose kem qasje të qëllimshme në materiale që mund të konsiderohen fyese ose të paligjshme. Nëse rastësisht has në ndonjë material të tillë, do t’ia raportoj këtë ndonjë anëtar të Federatës.
- Nuk do të përdor mediat sociale ose internetin për t’i dërguar dikujt material që mund të konsiderohet kërcënues, fyës, shqetësues, bullizues ose që është i paligjshëm.
- E kuptoj që duhet të përdor vetëm rrjetet sociale zyrtare të Federatës ose kanalet e komunikimit të faqes së internetit për t’i kontaktuar ata dhe nuk duhet të kërkoj komunikim privat me stafin ose trajnerët.
- E kuptoj që të gjithë mund të kenë qasje gjatë përdorimit tim të internetit dhe mediave sociale dhe se çdo çështje që ka të bëjë me sjelljen time në internet mund të adresohet nga trajneri im ose anëtarë të tjerë të Federatës.
- Nuk do të jap në internet asnjë informatë personale timen ose të dikujt tjetër (si emri, mosha, adresa ose numri i telefonit).
- Nuk do të ndajë fjalëkalimet e mia me askënd.
- Nuk do të organizoj të takoj dikë që kam takuar në internet, përveç nëse shoqërohem nga një anëtar i stafit ose prindi.
- Do të shmang përdorimin e telefonit mobil gjatë aktiviteteve sepse e kuptoj se do të ketë ndikim në sigurinë time dhe mundësinë time për të mësuar dhe për të arritur diçka.
- Jam i vetëdijshëm se nëse dikush më bullizon ose abuzon me mua në internet, mund të kontaktoj Vlora Brahën [+38345577058, spocperson@basketbolli.com]
- E di që nëse kam ndonjë shqetësim për diçka që kam pare ose përjetuar në internet mund të kontaktoj linjën për mbrojtje të fëmijëve 116 11 11.

Deklarata (nëse prindi e mbush këtë formë)	
Ne e kemi diskutuar këtë deklaratë dhe _____ pranon të mbështesë përdorimin e sigurt të internetit dhe mediave sociale në Federatën e Basketbollit të Kosovës	
Nënshkrimi	
Emri me shkronja të shtypit	
Data	

Deklarata (i rrituri/fëmija)	
Nënshkrimi	
Emri me shkronja të shtypit	
Data	

PROCEDURAT MË TË SIGURTA TË REKRUTIMIT DHE PËRZGJEDHJES



Procedurat më të sigurta të rekrutimit dhe përzgjedhjes ndihmojnë për të pasur një fuqi punëtore të sigurt dhe për të penguar dhe kontrolluar individët e papërshtatshëm. Ky dokument përshkruan hapat kryesorë për të pasur proces më të sigurt të rekrutimit.

Të gjithë përfitojnë nga procedurat efektive të rekrutimit dhe përzgjedhjes:

- Bashkëpunëtorët, përfshirë prindërit/kujdestarët, sigurohen se janë marrë masa për të rekrutuar vetëm njerëz të përshtatshëm për të punuar me fëmijët/të rinjtë/të rriturit e cenueshëm,
- Fëmijët dhe të rinjtë/të rriturit e cenueshëm mbrohen më mirë,
- Organizatat zvogëlojnë rrezikun për reputacionin e tyre.

Të njëjtat procedura duhet të zbatohen nëse bashkëpunëtorët paguhen ose nuk paguhen, punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme.

Hapat kryesorë për proces më të sigurt të rekrutimit për çdo pozitë

Pozita/përshkrimi i vendit të punës

- Përshkruan gamën e gjerë të detyrave, obligimeve dhe përgjegjësive të pozitës dhe ndihmon të gjithë të kuptojnë fushëveprimin dhe natyrën e pozitës.

Specifikimi i individit

- Përshkruan llojin e aftësive, përvojës dhe veçorive

të kërkuara për pozitën (p.sh. përvoja specifike, sportet ose kualifikime dhe kërkesa të tjera, siç është komunikimi efektiv me fëmijët).

Shpallja e vendit të punës/ pozitës

- Përfshin shpalljen ose promovimin e punëve me pagesë ose vullnetare për të pasur sa më shumë kandidatë dhe për të demonstruar një proces të hapur rekrutimi. Kjo mund të bëhet përmes: faqes së internetit të Federatës (dhe burimeve të tjera në internet). Tregoni se vendi i punës përfshin punën me fëmijë/të rriturit e cenueshëm dhe (nëse lejohet ligjërisht) se do t'i nënshtrohen kontrollit të së kaluarës kriminale.

Formulari për aplikim

- Kërkon që të gjithë aplikantët të plotësojnë formularin për aplikim që përfshin të gjitha pyetjet përkatëse. Federata e mban një kopje të këtij formulari për të caktuar intervistën/takimin pasues me kandidatin dhe për të identifikuar çdo boshllëk në historinë e tyre të punësimit/vullnetarizmit.

- Për postet përkatëse, formulari duhet të përfshijë (ose të lidhet me) një formular që lejon individin të vetë-deklarojë bindjet ose informacionet përkatëse dhe të japë pëlqimin e tij për kryerjen e një kontrolli të së kaluarës kriminale (nëse lejohet ligjërisht). Kandidatët duhet gjithashtu të plotësojnë një Formular të Vetë-deklarimit (që është i bashkëngjitur në fund të këtij dokumenti).

Referencat me shkrim

- Merrni të paktën dy referenca me shkrim, mundësisht edhe nga punëdhënësi i juaj i fundit (për vendet e punës me pagesë) ose mbikëqyrësin (për rolet vullnetare) (bashkëngjitur në fund të këtij dokumenti). Këto duhet të përfshijnë dikë që mund të tregojë për punën e mëparshme të aplikantit me fëmijët dhe/ose të rriturit e cenueshëm. Do të ishte ideale që referencat të kërkohen për të gjithë

kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë dhe të sigurohen para intervistës. Të gjithë personat e referuar duhet të kontaktohen drejtpërdrejt, p.sh. me telefon.

- Sigurohuni që informacioni i marrë nga të gjitha burimet u jepet atyre që duhet të marrin vendimin mbi përshtatshmërinë e individit për këtë pozitë.

Vlerësimi i rrezikut të informacionit

- Krijoni një sistem për vlerësimin e rrezikut të informacionit të kthyer nga ndonjë prej burimeve të mësipërme. Mos punësoni ose angazhoni individin derisa kjo të përfundojë. Vlerësimet e rrezikut për çdo informacion që dalin gjatë procesit të rekrutimit duhet të ndërmerren nga një individ me përvojë/ trajnim të duhur, për shembull, dikush që ka përgjegjësitë kryesore të mbrojtjes.

Intervista

- Sigurohuni që stafi ose vullnetarët t'i nënshtrohen intervistës ose të takohen me së paku dy përfaqësues të Federatës.

- Kontrolloni çdo boshllëk në formularin e aplikimit dhe sigurohuni që aplikanti ka aftësitë dhe është i përkushtuar për të përmbushur dhe për t'iu përmbajtur standardeve të kërkuara në politikën e mbrojtjes së Federatës.

- Ndoshta ju kërkohet të shikoni qëndrimin e aplikantit ndaj pushtetit, autoritetit dhe disiplinës dhe të kërkoni përgjigje ndaj një problemi me të cilin përballet Federata juaj për të vlerësuar angazhimin e tyre për të promovuar praktikat e mira dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me fëmijët dhe të rriturit e cenueshëm.

Kontrollimi i identitetit dhe kualifikimit

- Merrni dhe shikoni dokumentet përkatëse që konfirmojnë identitetin e kandidatit (p.sh., kërkoni dokument identifikimi me fotografi (letërnjoftim), kualifikimet, përvojën dhe të drejtën për të punuar. Sqaroni çdo boshllëk të dukshëm në punësim.

Kontrollimi i së kaluarës kriminale

- Federata duhet të ketë dhe të ndjekë udhëzime të qarta për të përcaktuar se cilat pozita janë të pranueshme për kontrollet e së kaluarës kriminale që përputhen me legjislacionin kombëtar dhe duhet të sigurojë që aplikantëve që aplikojnë për pozita të caktuara u kërkohet të respektojnë këtë. Informacioni në lidhje me dënimet e mëparshme kriminale ose shqetësime të tjera duhet të vlerësohet si më sipër.

Periudha e përkohshme/ provuese

- Caktoni një periudhë të përkohshme/provuese (zakonisht 6 muaj) dhe rishikoni performancën e punëtorit, gjegjësisht a është performanca në pajtueshmëri me përshkrimin e vendit të punës.

- Sigurohuni që të gjitha emërimet të bëhen nga Komiteti Ekzekutiv dhe jo nga ndonjë anëtar/e individual/e i/e Federatës.

Fillimi i punës

- Sigurohuni që sa më shpejt të jetë e mundur të gjithë rekrutët e rinj i nënshtrohen procesit të njoftimit me punën e re (trajnimit) (që do t'i ndihmojë ata të dinë për të gjitha aspektet e rëndësishme të mjedisit të tyre të ri) në mënyrë që të familjarizohen me politikat dhe procedurat e mbrojtjes së Federatës ose ngjarjeve dhe përgjegjësitë e pozitës.

• Kërkoni nga rekrutët e rinj të familjarizohen dhe të regjistrohen në Politikën e Mbrojtës së Federatës, politikat dhe udhëzimet përkatëse, Kodet përkatëse të sjelljes për pozitën e tyre, rregulloret dhe politikat për ngjarjet.

• Përcaktoni se çfarë trajnimi do të ishte i dobishëm/i nevojshëm për rekrutët e rinj, bazuar në rolin dhe përvojën e tyre. Sigurohuni që të gjithë rekrutët e rinj ose të kenë kryer së fundmi trajnimin adekuat të mbrojtjes (nëse është e përshtatshme në përputhje me kërkesat përkatëse të Federatës) ose ta bëjnë këtë sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se gjashtë muaj pas marrjes së pozitës së tyre.

Formulari i referencës

për vendet e punës me fëmijë/të rritur të cenueshëm

Emri i kandidatit	
Pozita që keni aplikuar	
Emri i organizatës	

Personi i lartpërmendur ka shprehur interesim për të punuar në organizatën tonë dhe ka dhënë emrin tuaj si referencë. Pozita përfshin qasje dhe përgjegjësi të konsiderueshme me fëmijët dhe/ose të rriturit e cenueshëm.

Si një organizatë e përkushtuar për mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve të cenueshëm, dëshirojmë të dimë nëse ka ndonjë arsye për t’u shqetësuar në lidhje me përshtatshmërinë e këtij kandidati për këtë pozitë.

Nëse keni mundësi të plotësoni këtë formular të referencë, si dhe ju sigurojmë se çdo informacion do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse. Informacioni do të ndahet me personin që bën vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për pozitën dhe vetëm nëse atij i ofrohet pozita në fjalë. Ne do të vlerësonim nëse do të jeni të hapur dhe të sinqertë në vlerësimin tuaj për këtë person.

Çka dini për kandidatin?		
Datat e punësimit ose punës vullnetare (DD/MM/VV)	Prej:	Deri:
Në çfarë cilësie ka qenë i punësuar/e njihni kandidatin:		
Detyrat kryesore:		

Çka dini për kandidatin?

Ju lutemi komentoni për përshtatshmërinë dhe aftësinë e përgjithshme të kandidatit për të punuar me fëmijë/të rinjtë/të rriturit e cënueshëm:

Ju lutem notoni kandidatin për cilësitë e mëposhtme:					
	Dobët	Mesatare	Mirë	Shumë mirë	Shkëlqyeshëm
Përgjegjësia	☐	☐	☐	☐	☐
Pjekuria	☐	☐	☐	☐	☐
Vetë-motivimi	☐	☐	☐	☐	☐
Aftësia për të motivuar të tjerët	☐	☐	☐	☐	☐
Energjia	☐	☐	☐	☐	☐
Besueshmëria	☐	☐	☐	☐	☐
Besimi	☐	☐	☐	☐	☐

Shqetësimet për mbrojtjen dhe ruajtjen e fëmijëve

Kjo pozitë përfshin kontakt të rregullt me fëmijët dhe/ose të rriturit e cënueshëm. Si organizatë e përkushtuar për mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve të cënueshëm, dëshirojmë të dimë nëse jeni në dijeni për ndonjë arsye pse ky person mund të mos jetë i përshtatshëm për të punuar me fëmijët/të rriturit e cënueshëm.	☐ Jo	☐ Po– ju lutem tregoni më shumë:
---	-----------------------------	---

Shqetësimet për mbrojtjen dhe ruajtjen e fëmijëve

A jeni në dijeni për ndonjë akuzë, sanksion dhe/ose masë disiplinore të mëparshëm të bazuar ndaj këtij personi ku ka pasur shqetësime në lidhje me sigurinë ose mbrojtjen e fëmijëve/të rriturit e cënueshëm?	☐	Jo
---	--------------------------	----

A jeni në dijeni për ndonjë akuzë ose hetim aktual ose në vazhdim, ose për ndonjë sanksion disiplinor që është në fuqi ndaj këtij personi? Kjo edhe mund të mos lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve/të rriturit e cënueshëm.	☐	Jo
--	--------------------------	----

A do ta ri-punësonit ose a do ta ri-an-gazhoniit për punë vullnetare këtë person?	☐	Jo – ju lutem tregoni më shumë:
---	--------------------------	---------------------------------

Informata të tjera

Ju lutemi shtoni çdo informatë ose koment tjetër që mendoni se është i rëndësishëm për personin në pozitën e re të propozuar:

Të dhënat tuaja dhe deklarata

Emri	
Organizata	
Pozita	
Numri i telefonit	
Nënshkrimi	
Data	

Ju lutem përcilleni te:

[vendosni të dhënat e Federatës]

Nëse paraqitet ndonjë shqetësim në lidhje me informacionin e ofruar nga personi i referuar për vendet e punës me fëmijë dhe/ose të rriturit e cenueshëm, ne do të jemi në kontakt me të referuarin për të parë tutje dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e personit për të punuar në një pozitë të tillë.

Formulari i vetë-deklarimit

Private dhe konfidenciale

Të gjitha informatat do të trajtohen si konfidenciale dhe do të menaxhohet në përputhje me legjislacionin dhe politikën përkatëse për mbrojtjen e të dhënave.

Informatat për punonjësin ose vullnetarin

Emri				
Adresa				
Numri i telefonit				
Data e lindjes				
Gjinia (opsionale)	☐ Femër	☐ Mashkull	☐ Jo-binar	☐ Një përshkrim tjetër (luteni ta deklaroni)

Çdo informatë e paraqitur në këtë formular do të shihet në kontekstin e përshkrimit të pozitës, natyrës së shkëljes dhe përgjegjësisë për kujdesin e anëtarëve ekzistues të komunitetit të basketbollit. Nuk do të thotë se nuk mund të punoni/punoni si vullnetar me ne Nëse akoma jeni në ndonjë proces gjyqësor. Informacioni i dhënë mund të vlerësohet krahas kritereve normale të përzgjedhjes për të përcaktuar përshtatshmërinë për pozitën për të cilin aplikoni. Një marrëveshje e veçantë do të bëhet me ju nëse kërkohet sqarim për të diskutuar çdo çështje rreth informatës së ofruar përpara se të arrihet një vendim përfundimtar.

Deklarata

A jeni në ndonjë proces gjyqësor ose i liruar me kusht?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem shihni 2 opsionet më poshtë
Opsioni 1: Ju mund të zbuloni dosjen tuaj kriminale në një fletë të veçantë, me kusht që të shënoni një kryq në vijën më poshtë dhe t’i bashkëngjitni detajet në një zarf të lidhur me këtë formular. Zarfi duhet të shënohet me KONFIDENCIALE dhe të ketë emrin dhe të dhënat tuaja për pozitën që keni aplikuar. Bashkëngjitur keni detajet e dënimit tim veçmas _____ (ju lutem shënoni me X, nëse është e përshtatshme.)		
Opsioni 2: Ju lutemi jepni detajet e proceseve gjyqësore ose lirimit me kusht në hapësirën e ofruar:		
A jeni akuzuar zyrtarisht për ndonjë vepër tjetër në ndonjë shtet tjetër që ende nuk është bërë e ditur?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë
A jeni aktualisht nën hetime ose ndjekje kriminale nga policia në ndonjë shtet tjetër që mund të ketë ndikim në përshtatshmërinë tuaj për këtë pozitë?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë

A ju ka njohur në të kaluarën shërbimi social ose policia si person me rrezik ose rrezik të mundshëm për fëmijët/të rriturit e cenueshëm?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë
A ka ndërmarr ndonjë organizatë ndonjë veprim formal, hetim disiplinor dhe/ose sanksion ndaj jush për shkak të shqetësimeve për sjelljen tuaj ndaj fëmijëve/të rriturve të cenueshëm?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë
A jeni pushuar ndonjëherë nga puna, puna vullnetare ose pozitë tjetër e mëparshme për sjellje të pahijshme në rrethana që mund të kenë ndikim në përshtatshmërinë tuaj për këtë pozitë?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë
A i nënshtroheni aktualisht ndonjë hetimi ose procedimi të organit rregullator, qeverisës ose licencues të ndonjë shteti që mund të ketë ndikim në përshtatshmërinë tuaj për këtë pozitë?	☐ Jo	☐ Po – ju lutem ofroni informata shtesë

Konfirmimi i deklaratës

Ju lutemi, shënoni kutitë më poshtë dhe më pas nënshkruani këtë formular:

☐	Pajtohem që informatat e dhëna këtu mund të përpunohen për qëllimet e rekrutimit dhe e kuptoj që një ofertë pune/pozite vullnetare mund të tërhiqet ose mund të rezultojë me largimi nga puna nëse nuk i zbuloj informatat dhe rrjedhimisht organizata dëgjon në ndërkohë.
☐	Në përputhje me procedurat e organizatës, nëse është e përshtatshme, unë pranoj që organizata të bëjë kontrollin e së kaluarës kriminale dhe jap pëlqimin që të sqarohet çdo informatë e zbuluar me agjencinë që e ofron atë.
☐	Pajtohem të informoj organizatën brenda 24 orëve nëse në ndërkohë hetohem nga ndonjë agjenci ose organizatë në lidhje me shqetësimet në lidhje me sjelljen time ndaj fëmijëve ose të rriturve të cenueshëm.

Deklaroj se informatat e dhëna në këtë formular janë të sakta. E kuptoj që paraqitja e dokumentit të së kaluarës kriminale jo domosdoshmërisht do të më pengoj nga marrja e këtij vendi të punës.

Nënshkrimi	
Emri me shkronja të shtypit	
Data	

SAFEGUARDING *The* FUTURE



Co-funded by
the European Union

